

Eqrem Basha – një ndër shkrimtarët e rëndësishëm të letërsisë shqipe, akademik, njohës i kinematografisë, televizionit, arteve pamore dhe përkthyes i shquar. Me një jetë të aktive që nga vitet '70, deri në vitet '90, kur dëbohet me dhunë nga TV Prishtina. Ai flet për një monument të rëndësishëm siç ishte gazeta "Rilindja"...

EQREM BASHA

**Komunikimi ynë,
paradoksalisht, ende i vështirë
dhe i pamjaftueshëm**

**NUK E GJEN NJË GAZETË TIRANASE NË
PRISHTINË DHE NJË PRISHTINASE NË TIRANË!**



Skicë nga Bujar Kapllani

OPINION

LETËRSIA E GRAVE

Nga Violeta Murati

(fq. 5)

Doli nga shtypi "Ikona e Skënderbeut në jetën kulturore dhe artistike të Venedikut (Nga historia te miti: shekujt XV-XVIII)", një vepër e re e profesoreshës Lucia Nadin, përkthyer dhe përgatitur për botim nga Evalda Paci



Lucia Nadin

EVALDA PACI:
**"IKONA E SKËNDERBEUT",
SI U SHKRUA VEPRA
PËR KULTURËN SHQIPTARE
NË VENEDIK**

(fq. 12)

ESE



DITA E VERËS

Nga HYJNI CEKA

Më 14 mars, edhe në Skrapar të gjendesh, edhe mes Labërisë, në kodrat e Filatit e në Lug të Drinit, do të zgjohesh me tringëllimën e zileve e të këmborëve...

(vijon në fq. 6)

"Dome" pati një lindje të vështirë...

Nga Stefan Çapaliku

(fq. 8)

Leximi i poezisë "Hera-herës" të Mariklena Niços


Nga Entela Tabaku

(fq. 10)

Gjergj Fishta dhe folklori

Nga Tonin Çobani

(fq. 11)



Nga G. G. Márquez

(Fq. 14)



**REXHEP
FERRI**
MË MIRË TË
QAJ NJË DITË
SE ÇDO DITË

BIBLIOTEKË

**VIRGJIL
MUÇI**
MË E DËMOS-
DOSHME KRIPA
SE MJALTI



Eqrem Basha – një ndër shkrimtarët e rëndësishëm të letërsisë shqipe, akademik, njohës i kinematografisë, televizionit, arteve pamore dhe përkthyes i shquar. Me një jetë të aktive që nga vitet '70, deri në vitet '90, kur dëbohet me dhunë nga TV Prishtina. Ai flet për një monument të rëndësishëm siç ishte gazeta "Rilindja", ku nisi karrierën dhe lidhi miqësi me Anton Pashkun, Arbën Xhaferrin, Ali Podrimjen, Ibrahim Rugovën etj. Si një nga themeluesit e shtëpisë botuese "Dukagjini", shkrimtari sjell dëshmi ekzistenciale në letërsinë e dy vendeve tona dhe mban qëndrim pse komunikimi ynë nuk është i mjaftueshëm ende sot

EQREM BASHA KOMUNIKIMI YNË, PARADOKSALISHT, ENDE I VËSHTIRË DHE I PAMJAFTUESHËM

**NUK E GJEN NJË GAZETË TIRANASE NË PRISHTINË
DHE NJË PRISHTINASE NË TIRANË!"**

Intervistoi: Violeta Murati


Që nga biseda jonë e fundit në maj 2005, na treguat se në vitet '90 ju ishte botuar një libër nga shtëpia botuese "Naim Frashëri" dhe më pas ishit prezent në Shqipëri me disa libra dhe nxorët definicionin se paraqitja e autorëve duhet të bëhet pak më e rrënjësishme... Çfarë mendoni se ka ndryshuar, ose mbetur në vend, në këtë komunikim kulturor, herë të panatyrshëm (kujtoj propagandën politike mes dy vendeve) dhe herë në heshtje totale...?

Në të vërtetë, pas botimit të një përzgjedhjeje të poezisë sime, të përgatitur nga Xhevair Spahiu, që doli më 1990 te "Naim Frashëri", në Shqipëri ka dalë edhe një vëllim me tregime të pabotuara më parë, *Shtëpia e mallit*, tek "Ideart". Cikle me poezi, tregime dhe ese janë botuar shpesh në shtypin e përditshëm dhe në atë periodik. Komunikimet tona, paradoksalisht, ende janë të vështira dhe të pamjaftueshme. Janë shumë autorë të njohur e të rëndësishëm nga Kosova që gati nuk njihen në Shqipëri, botimet që dalin këndej gjejnë me shumë vështirësi rrugën për te lexuesi në Shqipëri. Mbeten vetëm panairët e librit, të vetmet mundësi për komunikime pak më të afërta, por që nuk mjaftojnë, gjithsesi, dhe jo në atë formë.

Botimet e autorëve nga Kosova andej dhe nga Shqipëria në Kosovë, nuk do të ishin dhe aq të nevojshme po qe se libri do të komunikonte lirshëm. Ç'rëndësi do të kishte nëse romanet e mia janë botuar te "Dukagjini" apo te "Koha" dhe jo te një botues në Tiranë, nëse do të ishin siç janë në Prishtinë, edhe në libraritë e Tiranës, apo sikur shtypi atje të merrej siç merret me autorët tiranas edhe me prishtinasit. Nuk them se ky komunikim është i bllokuar, por është gjithnjë i pamjaftueshëm, edhe pse besoj se nuk ka dhe nuk di pse do të kishte barriera. Fundja, ku do të shkosh më larg, kur nuk e gjen një gazetë tiranase në Prishtinë dhe një prishtinase në Tiranë!

Do të thosha se pak më e mirë është njohja e lexuesit

kosovar me botimet që vijnë nga Shqipëria, është më i madh interesimi, më i dendur prezantimi i librit dhe më i shpeshtë kontakti me autorë, sado që ende i pamjaftueshëm. Mbase këtu kanë merita libraritë e Prishtinës, janë dy-tri pak më këmbëngulëse për librin që botohet në Shqipëri, por janë të rralla libraritë e Tiranës ku i gjen botimet e Prishtinës, apo edhe ato të Shkupit e qyteteve të tjera nga Kosova e Maqedonia. Do të duhej një angazhim më i madh, gjithsesi, për



propagandimin e botimeve përmes gazetave, portaleve e periodikëve, gjë që sot për sot duket se është i vogël dhe i pastimular.

Por unë mendoj se këtu kanë punë për të bërë institucionet e kulturës, që premtojnë shumë e bëjnë pak, apo nuk e bëjnë si duhet e sa duhet. Premtojnë me fushata e ballonë, pastaj shfryhen e fashiten. Unë them se mund të gjenden forma stimulimi, financimi, edhe për botuesit, edhe për shpërndarësit, edhe për bibliotekat. Nuk është se u mungojnë këshillat apo drejtoritë e librit, por sot edhe ata kanë vështirësi komunikimi. Nuk di të jenë takuar ndonjëherë dhe t'i kenë biseduar këto çështje. Të paktën të bisedonin si t'i furnizonin reciprokisht bibliotekat e qyteteve, të qendrave universitare, të shkollave që nuk kanë mjete të mjaftueshme të përtërijnë fondet e tyre.

Profili juaj është kompleks: letërsi, film, televizion, kritikë e arteve pamore, përkthime. Por letërsia mbetet në krye mendoj. Cilat janë ndikimet që ju shtyjnë drejt saj, kur keni nisur të shkruani?

Rrethanat e jetës ndonjëherë t'i imponojnë edhe interesimet, angazhimet, përcaktimet... Letërsia është shtylla, destinim i hershëm, që nga bankat e gjimnazit, mbase edhe më herët. Im vëlla që është 15 vjet më i madh, ishte dhe mbetet lexues i pasionuar. Ai sillte vazhdimisht libra në shtëpinë tonë në Dibër të Madhe, ndaj pasioni i leximit është i pari. Po të mos flasim për belbëzimet e fillimit, botimet nisën nga koha e universitetit. Ishte Anton Pashku, asokohe redaktor i rubrikës së kulturës te gazeta "Rilindja", që na çoi fjalë e na ftoi mua dhe një mik timin në zyrën e redaksisë, duke na ofruar mundësinë e botimit në suplementin e gazetës. Pastaj zura punë edhe vetë në gazetën "Rilindja" dhe aty mora detyrë, sipas afinitetit, të shkruaj për artet pamore dhe televizionin, që atëherë ishte në embrion. Nga artet pamore zura miqësi me piktorë e skulptorë që mbetën deri sot shokë, nisa të



ndjek ekspozitat, jo vetëm në hapësirat tona, por edhe nëpër Europë. Që në vitin 1973 nga një qëndrim pak më i gjatë në Bregun Azur, në Francë, unë shkruaja për idenë e “Muzeut imagjinar” të A. Malraux-it, të realizuar në Fondation Maeght në Saint Paul de Vence, hapjen e muzeut të mesazheve biblike të Chagall-it në Nicë, në të cilën mora pjesë edhe vetë, për muzeun e Renoir-it në Cagne sur Mer, të Fernand Leger-it në Biot, etj. Në fund të po këtij viti, me përgatitjet për startimin e Televizionit të Prishtinës, afërmendsh që startova edhe unë atje. Një kohë të gjatë isha redaktor i redaksisë së dramës, shkrova skenarë filmi e televizioni dhe u mora dendur me këtë veprimtari, paralelisht me letërsinë, në atë kohë që ishte periudha ime më aktive e botimeve, deri në vitin 1990, kur policia serbe mbylli me dhunë Televizionin dhe Rilindjen dhe na hodhi në rrugë.

Duhet të jetë domethënëse edhe për ju, siç përshkruhet gjithnjë, botimi i parë. Kur ka qenë kjo kohë për ju, mund ta kujtoni?

Libri i parë, përmbledhja e tregimeve *Shëtitje nëpër mjegull*, doli që në vitin 1971 te redaksia e botimeve “Rilindja”. Asokohe redaktor i prozës ishte kritiku dhe studiuesi i letërsisë, Ali Aliu. Unë dorëzoja me shumë drojë një dorëshkrim, me shpresë se do ta lexonte dhe do të më jepte disa sugjerime, ndërsa ai në takimin e radhës më tha se dorëshkrimi tashmë kishte shkuar në shtyp. Ishte sikur dikush të më ngjiste krahë për të fluturuar. Pak kohë pas kësaj, te “Bota e Re”, gazeta e studentëve, ku ishim angazhuar bashkë me Ibrahim Rugovën (kryeredaktor) dhe Rexhep Ismajlin, botova dhe librin me poezi *Opuset e maestros*. Ideja jonë ishte të nisim një edicion të ri botimesh me iniciativë të studentëve, e cila nuk zgjati shumë, doli një vëllim me poezi i Ali Podrimjes (*Hija e tokës*), një libër i Jacques Prévert-it (*Shi dhe kohë e bukur*) përkthyer nga Rexhep Ismajli, një vëllim i Musa Ramadanit dhe disa botime

të tjera, por nuk vazhdoi më tutje, sepse edhe neve na i dhanë udhët. Por kujtohen si kohë të entuziazmit dhe sakrificës, sado që nuk ishte e lehtë.

Çfarë ka qenë për ju “Rilindja”?

“Rilindja” ishte një monument, tempull i kulturës, jo vetëm për Kosovën, por edhe për të gjithë shqiptarët në ish-Jugosllavi e më gjerë. “Rilindja” kishte gazetën e përditshme, redaksinë e botimeve, disa revista dhe ndërmarrjen e shpërndarjes së librit. Thuhet se “Rilindja” ka botuar mbi 2000 tituj të autorëve shqiptarë (rreth 3800 tituj gjithsej), deri në vitin 1990 kur u mbyll me dhunë. Besoj i keni parë edhe ju, sidomos botimet e traditës, veprat e plotat të Naimit, Samiut, Ndre Mjedës, Nolit, De Radës... Pastaj “Rilindja” botoi edhe kompletin e Kadaresë në atë kohë, të prof. Çabejt, serinë e përkthimeve të autorëve të antikitetit. Për ne ishte si shtëpi e dytë. Të gjithë, në njëfarë mënyre, ishim pinjollë të “Rilindjes”. Në redaksinë e botimeve punonin Nazmi Rrahmani, Ali Podrimja, Anton Pashku, Fahredin Gunga, Rifat Kukaj, Sabri Hamiti, Rahman Dedaj... Ishte shembull i profesionalizmit, botimet recensionoheshin, kalonin redaktimet gjuhësore e teknike dhe librat dilnin me standarde. Aty kam botuar një pjesë të librave të mi, por edhe disa përkthime, sepse stimuloheshin shumë edhe përkthimet.

Në vitet ’72-’73, deri në ’90-ën, punonit në TV Prishtina, ku ju përjashtuan me dhunë... Çfarë ishte për ju kjo karrierë kaq e stuhishme dhe historia e largimit, si i keni përcjellë ngjarjet në Kosovë në këto vite?

Në vitet ’72-’73, thashë, isha gazetar te “Rilindja”. Është një periudhë që e kujtoj me nostalgji. Hyra i ri fare, ndërsa në redaksinë e kulturës asokohe punonin Anton Pashku, Gani Bobi, Vehap Shita, Ali Podrimja, Mensur Raifi, Ibrahim Kadriu... Ishin 10-12 gazetarë vetëm për rubrikën e kulturës të gazetës, e cila kishte

një faqe a dy kulturë çdo ditë, ndërsa të shtunave suplementin që ua shkonte revistave. Në Televizionin e Prishtinës u inkuadrova në fund të vitit 1973 apo në fillim të 1974-ës, sapo u themelua si institucion. Isha redaktor i redaksisë së dramës dhe një kohë redaktor përgjegjës i programit Kulturo-Artistik. Jemi alternuar me Arben Xhaferin, të cilin e pata koleg pune gjatë gjithë kësaj periudhe. Ishin kohë të vështira, por kemi arritur të realizojmë disa filma e drama televizive, seri dhe filma dokumentarë. Njëkohësisht, xhironim dhe shfaqje teatrore që pastaj i emetonim në terminin e dramës televizive. Kemi emetuar edhe shumë shfaqje të xhiruara të Teatrit Kombëtar të Tiranës, realizime që i merrnim asokohe nga Radiotelevizioni shqiptar. Ishte një periudhë kur televizioni nuk e ndiqte vijën e politikës represive, gjë që nuk i konvenonte pushtetit të atëhershëm, dhe vendosën ta zhbëjnë edhe radion, edhe televizionin, edhe “Rilindjen”, edhe Universitetin, shkollat... Më 2 korrik 1990 policia hyri me dhunë në Televizionin e Prishtinës dhe nxori jashtë të gjithë shqiptarët. Në të njëjtën ditë unë u gjeta në rrugë bashkë me time shoqe e cila asokohe ishte në Radio. Periudha që pasoi ishte ajo e shtypjes dhe represionit më të egër, kohë në të cilën e kishim të pasigurt edhe kafshatën e bukës.

U ndodhët disa herë në Francë pas kësaj kohe, duke u marrë kryesisht me projekte të dramaturgjisë frënge. Çfarë ishte kjo përvojë? Kujtojmë pasionin tuaj për Beckett-in dhe në këtë paralele, miqësinë me Anton Pashkun...

Paralelisht me veprimtarinë letrare, një kohë jam marrë edhe me përkthime. Diku nga viti 1976 e këndej është intensifikuar interesimi për dramaturgjinë frënge dhe krahas kësaj, përkthimi i saj në gjuhën shqipe. Ato vite unë botova, gjithnjë te “Rilindja”, një vëllim me tri drama të Eugene Ionesco-s, pastaj një vëllim me të gjitha dramat e Albert Camus (Kamy) dhe pak më vonë një tjetër vëllim me katër drama të Jean-Paul Sartre-it (njëra prej tyre e përkthyer nga R. Kelmendi). Në kohën kur u ndodha në rrugë, i përjashtuar nga Televizioni i Prishtinës, paraqita një projekt përkthimi të teatrit të Beckett-it te Ministria e Kulturës e Francës, e cila më akordoi një bursë për të qëndruar dy muaj në Arl. Teatrin e Beckett-it, çdo gjë që kishte ai në lëmin e dramës, e botoi në një vëllim shtëpia botuese “Buzuku”. Është një botim i rrallë, sepse ka brenda, përveç teksteve kryesore dramatike të tij (*Duke pritur Godonë, Fundi i Lojës, Ah ditët e bukura...*), edhe pjesët e shkurtra, edhe radio-drama, skenarë televizivë, grimca dramaturgjike të fundit të jetës së Beckett-it. Këtë ma ka thënë edhe Jerome Lindon, botuesi ekskluziv i Beckett-it tek “Editions de Minuit”, të cilin pata fatin ta njoh e ta konsultoj dhe i cili m’i dha të drejtat e botimit. Pastaj kam qenë edhe me projekte të tjera në Francë, midis të cilave edhe për antologjinë *Teatri frëng i shekullit XX*, ku janë përfshirë 15 autorë me nga një dramë, nga Alfred Jarry deri te Yasmina Reza, e prezantuar si një diagonale e absurdit dhe botuar nga “Dukagjini”.

Në gjithë këtë punë, gjithsesi, meritë të veçantë ka Anton Pashku, me nxitjen dhe stimulimin e të cilit në fillim përktheva dhe botova Ionesco-n, Camus-in dhe Sartre-in. Ai asokohe te “Rilindja”, përveç të tjerave, merrej edhe me botimin e dramës. Por me Pashkun na lidh një miqësi e hershme. Në fakt, ju thashë më lart, ishte ai që botoi poezitë dhe tregimet e mia të para te suplementi i kulturës te gazeta “Rilindja” e pastaj e kisha edhe redaktor te rubrika e kulturës kur zura punë, para se ai të kalonte te redaksia e botimeve “Rilindja”. Fundja, tek ai botova edhe një tjetër vëllim me tregime, *Mëngjesi i një pasditeje*.

Diku nga viti ’94 i hyni sfidës së botimit, themeloni shtëpinë botuese “Dukagjini”... Pse përfshirja juaj në editori, si e shikoni këtë marrëdhënie me shkrimtarin sot?

Ideja e themelimit të shtëpisë botuese “Dukagjini” nuk ishte vetëm e imja. E para ishte gatishmëria e shtypshkronjës “Dukagjini”, përmes z. Agim Lluka që asokohe vepronte në Pejë, për të përkrahur propozimin e një grupi krijuesish, autorësh, si: Rexhep Ismajli, Gani Bobi, Shkëlzen Maliqi dhe unë, që dolëm me një

projekt për themelimin e një shtëpie botuese, me detaje, i cili u përcoll vite me radhë ashtu siç ishin saktësuar në dokumentin e nënshkruar më 14 mars 2014. Sivjet bëhen 25 vjet. Ishin kohë të vështira. Të gjithëve na ishin bllokuar rrugët e aktiviteteve dhe të botimeve. Unë punoja në revistën javore “Koha”, anëtarët tjerë të redaksisë mbanin orët në sistemin paralel të mësimin nëpër shtëpi private, ishim në zgrip të ekzistencës dhe shansi që ofroi “Dukagjini” ishte i papritur. Të kuptohemi, edhe për ata kjo ishte sakrificë e madhe, sepse represioni ushtrohej tejet i egër. T’ju kujtoj se për të realizuar promovimin e parë të botimeve të “Dukagjinit” në Tiranë i patëm transportuar librat në mënyrë klandestine me një barkë përmes Liqenit të Shkodrës. “Dukagjini” për një kohë të shkurtër erdhi e u bë njëra nga shtëpitë më të mëdha botuese, jo vetëm në Kosovë. Në fillim me dy seritë e botimeve, “Fryma” (dijet humane) dhe “Rozafa” (letërsi), e më vonë me “Dukagjini Balkan Books”, një seri botimesh në gjuhë të huaja, anglisht, gjermanisht e frëngjisht, ku kishim në redaksi edhe Robert Elsie-n, ajo sot është shtrirë edhe në fushën e teksteve shkollore dhe është lider në këto botime.

Shumë pake dinë, këtej në Shqipëri, se në vitin ’99 ju boton prestigjiozja frënge “Fayard”, se jeni prezent në shumë gjuhë përmes antologjive dhe përmbledhjeve poetike, si serbisht, polonisht, gjermanisht, anglisht etj., dhe me një agjendë intensive në takime letrare e festivale poezish, sallone libri... Pse ky komunikim bëhet i rëndësishëm për shkrimtarët?

Më se i rëndësishëm. Botimi me tregimet e përkthyer te “Fayard” (*Les ombres de la nuit*) erdhi menjëherë pas luftës në Kosovë dhe udhëtimi në Paris me time shoqe, me të cilën kishim qëndruar të mbyllur në Prishtinë gjatë bombardimeve, ishte sikur të shkonim në një sanatorium për t’i shkundur streset e luftës. Një promovim i këtij libri asokohe u organizua në kuadër të festivalit të madh të teatrit në Avinjon. Ishte e ndjera përkthyesja Christiane Montecot (që kishte përkthyer librin me Aleksandër Zoton) që i organizoi të gjitha. Duke mos qenë në gjendje të kontaktonin me mua, ishin lidhur me tim vëlla në Dibër, për ta njoftuar dhe për t’i dërguar kontratën e botimit. Libri u ndoq me plot aktivitete dhe pati jehonë në shtypin francez. Një promovim interesant u zhvillua edhe në qytetin e filozofit të madh, Ferney Voltaire. Në këto kohë u përgatit dhe një vëllim me poezi që u përkthye polonisht nga Mazllum Saneja dhe Ewa Smietanjska, që gjithashtu u ndoq me shumë aktivitete në Sejni, qyteti i botuesit “Pogranitze” dhe Varshavë. Vëllime me poezi dolën edhe në Nju-Jork, përkthyer nga Robert Elsie, një tjetër në esperanto, një në serbisht, në maqedonisht, ka pasur pastaj shumë përkthime në revista, antologji, panorama poetike apo përzgjedhje të poezisë europiane e botërore, pastaj antologji të tregimit, në gjermanisht, anglisht, frëngjisht, etj. Në vitin 2017 botuesi francez “Voix d’encre” nga Montelimar botoi një libër me poezinë time (*L’homme nu*), përkthyer nga Aleksandër Zoto, i cili shkroi dhe parathënien, ndërsa në vitin 2018 doli romani *Lakorja e ik’sit* (*La ligne de fuite*) te botuesi parisien “Non Lieu”, me përkthim të Sebastien Gricourt.

Jeni lindur në Dibër... Çfarë merr njeriu nga vendi i origjinës?

Merr mallin, kujtimet e fëmijërisë jo dhe aq të lehtë. Merr gjakun me vete, atë që të rrjedh në damarë dhe i duket se është i veçantë. Merr njëfarë identiteti. Dibranët kanë qejf të mburren me qytetin e tyre i cili, për fat të keq, sot ka mbetur një grusht, me ethet e skamjes dhe emigrimit. Unë edhe sot e kësaj dite nuk ndalem së hapuri portalet që sjellin lajme nga Dibra, i di të gjitha detajet rreth ndërtimit të Rrugës së Arbrit dhe vonesave që e ndjekin, kam nënshkruar petitionin që kërkon azhurnimin e përfundimit të asaj arterieje të rëndësishme dhe vitale edhe për Dibrën e Madhe, i vetëdijshëm se çfarë të mirash do t’i sjellë, takohem kohë pas kohe me dibranët që jetojnë në Prishtinë, për të pirë një kafe dhe për të shpërlarë pak gojën dibrançe. Nuk del dot nga lëkura. Shkoj më rrallë, është e vërtetë, kam një vëlla që jeton atje, por e kam gjithnjë me vete kujtimin që nuk zhbëhet.

Ju jeni marrë me këtë qytet ndoshta edhe për shkak të dramës që ka, kufirit. I keni kushtuar një roman, *Varrë* – çfarë plage është kjo?

Romani *Varrë* erdhi pas një rezidence që pata në qytetin e Gracit në kufi të Austrisë me Slloveninë, në një projekt që quhej “Poetika e kufirit”. E kishim për obligim në fund të dorëzonim një ese mbi këtë temë. Unë shkrova *Rrëfimi për babanë, atletin e kufirit*, i cili pastaj u përkthye gjermanisht dhe u botua fillimisht në revistën “Lichtungen” dhe në një vëllim të veçantë ku ishte edhe nobelistja Herta Müller dhe pjesëmarrësit e tjerë në këtë projekt. Reagimi i parë kur u botua ishte se kisha shkruar një ese-fiksion. Në të vërtetë, unë kisha paraqitur aty gjithë historinë e tim eti me kufirin që Dibrës i bie në të tria anët e saj. Vetëm njërën anë e ka nga Maqedonia, ku është tash. U dukeshin të pabesueshme të bëmat e babait dhe lufta e tij me kufirin. Ne kishim farefisnin edhe në këtë anë edhe në atë anë, të mitë kishin jetuar deri në vitin 1942 në Tiranë, im vëlla kishte lindur atje dhe pastaj kishin vendosur të ktheheshin në vendlindje. Një pjesë e familjes jeton edhe sot në Tiranë, ku mbase ka më shumë dibranë se ç’ka sot qyteti i Dibrës së Madhe. Këto ndarje, sjellin histori nga më të pabesueshmet dhe më të trishtueshmet që ka shkaktuar kufiri. Në një promovim të këtij romani në Universitetin e Humboltit në Gjermani u shpalosën rrëfimet rrëqethëse me pjesë të romanit të përkthyer gjermanisht dhe në kuadër të një projekti për ndryshimet që ka shkaktuar te qytetarët e fshatarët e gjithë krahinës së Dibrës, këndeje e andej kufiri. Janë histori tronditëse që unë i njoh jo vetëm nga rrëfimet, që na e kanë zaptuar jetën dhe na e kanë bërë – varrë!

Si e keni përjetuar lirinë e Kosovës, shpesh nga andej thuhet se nuk është menaxhuar mjaftueshëm apo...?

Liria e Kosovës është një mrekulli që do kohë për ta kuptuar siç duhet e për ta vlerësuar. Vetëm ta dini flladin e atyre ditëve të para kur mund të merrnim frymë me gjithë mushkëritë. Për ne që i kemi kaluar të gjitha dhe kemi ende plagët që kullojnë në kujtimet tona, por edhe nga dhembjet e përditshme të njerëzve

që kanë humbur më të afërmit e që një pjesë e tyre nuk janë në gjendje as varrin t’ua gjejnë, pazaret që bëjnë sot sharlatanët dhe të papërgjegjshmit dhe rreziqet që ia ndërsejnë, nuk vijnë nga ata që e dinë se sa e shtrenjtë është ajo.

Sa e vështirë ka qenë Prishtina juaj? Si bëhet qyteti për një shkrimtar?

Ju me siguri e kujtoni një poezi të hershme timen, *Larësit e Prishtinës*. Është shkruar në kohën e demonstratave dhe protestave të viteve ’80-’90 (*Kush ma di qytetin / me sandale fëmijësh/ mbi gjurmë tankesh/ me vocërrakë të zhjatur/ që pinë ujë në gëzhoja lotsjellësi... në morgun gjithnjë të zgjuar/ të spitalit të Europës*). Është Prishtina që kujtoj unë, Prishtina e ditëve të përgjakshme, e turmave që binin në “gjurmët e tankeve”. Ia di të gjitha stinët. Jam rritur bashkë me të. Kam më shumë se pesëdhjetë vjet jetë në këtë qytet. Nga perspektiva e sotme, kur sheh sprovat e sfidat e kaluara, të duket se çdo gjë ka qenë vetëm ëndërr e trishtuar. Por tjetër ka qenë t’i jetosh dhe t’i ndiesh në lëkurë. Sidoqoftë, aty janë edhe ditët e rinisë dhe të dashurisë që kanë kaluar, aty janë fëmijët që kanë ardhur dhe që kanë sjellë fëmijët e tyre, aty është gjithë jeta, aty ku kam ardhur shtalb, i ri fare dhe jam bërë gjysh. Çfarë ka mbetur nga e djeshmja, çfarë ka ndryshuar nga frymëzimet e hershme? Në vitin e largët 1967 ai ishte një qytet i vogël 60-70 mijë banorë. Kufijtë e jashtëm të qytetit të atëhershëm sot janë thuaja qendra e tij. Po shndërrohet në metropol, ndërsa unë kam ikur në paralagje, se nuk e gjej dot qetësinë e dikurshme. Ke shumë për të thënë për Prishtinën dhe asnjëherë nuk i thua të gjitha. Qyteti bëhet si një gjymtyrë, një organ vital, pjesë e trupit dhe organizmit tënd.

A ka heshtje në letërsi? Ju keni ndërtuar një roman të tërë mbi këtë metaforë, subjekt, te *Lakorja e ik’sit*...

Kjo do të thotë se nuk jeni për letërsinë e angazhuar?


Mbase mund të pretendohet se edhe ky nuk është njëfarë angazhimi. Them se është heshtje që flet. Nuk është për herë të parë në krijimet e mia. Haset shpesh në poezi. Shumë herët, si student, kisha hartuar një seri aforizmash për heshtjen. Një ditë një mik më tha: ke portretizuar vetveten. Jo. Mund të ketë copa të miat aty brenda, por nuk jam unë. Një angazhim me heshtje (Iksi, Ik’si, Ikësi) mbase mund të duket paradoksal. Në fakt, çështja e letërsisë së angazhuar është diçka për të cilën unë nuk jam në gjendje të flas qartë, sepse në momentin kur e përjashton letërsinë e dogmatizuar, që nuk është vetëm angazhim, por edhe propagandë, pamflet, pllakat, mbetet shumë relative se çkafit do t’i thuash letërsi e angazhuar.

Poezia juaj godet tamam si fryma e poezive të Zhak Preverit, enigmatike dhe tërheqëse. Cila është ithtaria e poezisë moderne?

Kam nisur me prozë. Libri i parë është me tregime, mbase për këtë arsye ka mjaft rrëfim, narracion, balada urbane, njësoj siç mund të ketë problematika të njeriut urban tek tregimet. Tjetër është Preverti që përmendni ju. Komunikimi është i domosdoshëm, sipas mendimit tim, nuk jam ithtar i poezisë tejet hermetike, edhe pse mund ta kem shkruar vetë në ndonjë periudhë të caktuar. Nuk më takon mua ta them, por e dua vargun që komunikon dhe në të njëjtën kohë, është modern e avangard, në mënyrën se si komunikon. Kjo poezi ka kaluar në periudha të ndryshme të ekzistencës sonë dhe ndonjëherë mbase mund të ketë qenë më e mbyllur, por nëse në kohët e vështira ka folur për “shefin e bandës iks, që formon shtetin e zi, me parlament të zi...” lidhur me realitetin tonë të asaj kohe, por edhe me trendin e poezisë së asaj kohe, besoj se i shkon pas një qëllimi.

Sartër, Kamy, Ionesko... kujtojmë angazhimin tuaj si përkthyes, e këta janë autorët e tu që besojmë ua kanë bërë më të qartë rrjedhat e njohjen më të gjerë në letërsi apo jo? Te ne përkthimet kanë nisur vonë, për shkak të ndalesës. A mund të kontekstualizoni letërsinë shqipe në këtë vështrim, çfarë e dallon?

Kam bërë shumë përkthime, e përmenda edhe më lart. Kam përkthyer edhe vepra të tjera të autorëve të mëdhenj. Malraux, për shembull (*Pushtuesit*) ose Claud Levi-Strauss (*Mendimi i egër*). Dikur herët (1982) kam përkthyer dhe poezinë e Ungaretti-t (*Një jetë njeriu*),



“

Nuk plakemi për mendimet

e të tjerëve, nuk themi se

tashmë nuk më intereson se

ç’mendojnë të tjerët, asnjëherë.

por teatri ka qenë ai që ka dominuar, edhe pse vetë nuk kam shkruar për teatër. Por janë autorët ata që më kanë tërhequr (Camus, Sartre, Ionesco, Beckett...). E them se përkthimi është edhe një lexim i thellë, analizë teksti, i nevojshëm për të hyrë në vorbullat e mendimeve të autorëve që i do. Më kujtohet që ndonjë kopje e Ionesco-s (i përkthyer më 1976) mbërrinte në Shqipëri, edhe Sartre apo Camus. Këta autorë dhe poetë, si Rimbaud, Baudelaire, Aragon, Verlaine, janë ata që kanë ushqyer gjeneratën tonë. Ishim një rreth miqsh që merreshin me ta. Mensur Raifi doktoroi me Rimbaud-in dhe e përkthente, Rexhep Ismajli gjuhëtar, por edhe përkthyes i poezisë së mirëfilltë dhe lexues i përkushtuar i saj, i sillte këta autorë shpesh në shqip. Është literatura jonë e asaj periudhe, dyzet e më shumë vjet më parë. Sartre, Camus janë interpretuar shpesh në skenën e teatrit të Prishtinës. *Duke pritur Godonë* është vënë në skenë një vit pasi mori çmimin Nobel për letërsi (1970), jo me përkthimin tim, por me përkthimin e parë të Esad Mekulit.

Sa jeni në kontakt të të rejave letrare me autorët shqiptarë, si arrin të komunikosh personalisht me to?

E ndjek me shumë interes, me aq sa mundem. Është e natyrshme. Vij pothuaj rregullisht në panairin e Tiranës dhe ngarkohem me botimet e reja. Jam gjithnjë në kontakt me miqtë dhe përzgjedhjen e parë e bëj me ndihmën e tyre. Ka shumë botime sot dhe nuk mund të ndiqen të gjitha, por kam edhe dy lexues të pasionuar në familje, dy bijat, me të cilat ndajmë shpesh përvojat dhe japim rekomandime. Me një fjalë, nuk është se mund të kapërcejnë botime të rëndësishme pa pasur njohuri. Por tashmë jemi në vërshimin e një shumësie ofertash dhe midis të tjerash, çmohet edhe aftësia e përzgjedhjes. Pastaj, intensiteti i leximit nuk është ai që ka qenë para shumë viteve. Edhe leximi, njësoj si shkrimi, i ka pikat kulmore dhe të rënies në lakore.

Mos harroni, një pjesë e autorëve janë miq, se s'kemi si të mos njihemi mes veti, njësoj siç i kemi dhe botuesit miq e kolegë dhe këmbëjmë shpesh libra që i lexojmë e i diskutojmë.

Panairot e librit mes dy vendeve duket se janë këmbimi i ndërsjellë... A e shikoni të natyrshme, pas kaq vitesh liri, këtë hapësirë?

E thashë edhe më lart, për fat të keq, panairi i librit sot ka mbetur njëra nga të format e rralla të komunikimit me librin. Është tjetër gjë që ato ndonjëherë shndërrohen në tezga allishverishesh, por mbeten festë e librit, e kanë edhe rolin efikas të kontaktit të parë dhe të afërt me librit me lexuesin.

Jemi prapë në një pikë mjaft të nxehtë për shkrimtarët, që ka të bëjë me njohjen, për të mbërritur te lexuesi dhe për të marrë një vlerësim profesional nga kritika...

Nuk është se i takon vetëm kohës sonë. Kjo luftë dhe ky synim është i hershëm sa ç'është njeriu. Gjithnjë synojmë ta marrim mendimin e tjetrit kur i ofrojmë propozimin tonë. Nuk shkruajmë për veten tonë, nuk do ta botonim fare atëherë, duam të dimë si e vlerësojnë të tjerët. E kemi zakon, së pari, dorëshkrimin t'ia japim një miku që i besojmë dhe e presim me padurim mendimin. Pastaj, kur del në opinion, kërkojmë të dimë si është pritur, i duam mendimet, hollësisht po të jetë e mundur, sepse kjo sjell satisfaksionin, arsyen pse kemi ndërmarrë gjithë këtë punë. Kjo do të na japë mbase dhe stimulimin për më tutje. Nuk plakemi për mendimet e të tjerëve, nuk themi se tashmë nuk më intereson se ç'mendojnë të tjerët, asnjëherë. Gjithnjë kemi po atë padurim kur e hedhim në publik një vepër të re. Për fat të keq, sot ka pak vlerësime për librat në shtyp dhe në mediat e tjera, pak bëhet fjalë për letërsinë në përgjithësi. E kam fjalën për vlerësimet dhe leximet analitike, jo për informata dhe biseda ad hoc me shkrimtarë, si me personazhe për gosip. Unë mbaj mend që një kohë, kur punoja te "Rilindja", ishin të domosdoshme prezantimet me recensione të dy deri në katër titujve në javë. Kishte anëtarë të redaksisë që merreshin vetëm me këtë punë. Kurse sot mund të dalë libri dhe të plakët në heshtje, edhe për mirë, edhe për keq...

Letërsia e grave

Nga Violeta Murati

Është një zonë diskrete kur flitet për shkrimtarët gra ose letërsinë e shkruar nga gratë, sidomos në Shqipëri. Historikisht, duket se përvoja e grave është krijuar nga gjinia e tyre, të cilat jo pak herë janë parë edhe në kuriozitetin e studimeve. Në botë letërsia e grave si një fushë studimi është zhvilluar që nga vitet 1970. Ka shembuj në shekullin XVIII për katalogimin e shkrimtareve gra, ku është evidentuar letërsia dhe aftësia e tyre në art dhe shkenca të tjera. Por si diskutim më i hershëm për kontributin kulturor të grave mund të gjendet deri në shekullin VIII para Krishtit, kur Hesoidi përpiloi Katalogun e Grave, një listë nga heroinat dhe perëndeshat. Plutarku në veprën e tij bëri një listim të grave heroike. Ndërsa në periudhën mesjetare Bokaçio përdori femrat mitike dhe biblike si shembuj moral, duke frymëzuar direkt shkrimtaren Christine de Pisan për të shkruar librin "The Book of the city of Ladies" (1405).

Në këtë tangjente shkrimtarët gra duket se vetë kanë kohë që janë interesuar në gjetjen e një "tradite të gruas" në letërsi. Ndërsa te ne ende nuk është reflektuar nga ndonjë studim apo kritikë kjo "traditë". Por një gjë është e sigurt, se shkrimtarët gra nuk mund të konsiderohen veçmas nga bashkëkohësit e tyre meshkuj dhe nga tradita më e madhe letrare.

Nëse në Perëndim vala e feminizmit nxiti daljen në dritë të kontributit të grave, nga mendimi se janë të papërfaqësuar, te ne kjo është një zonë krejtësisht e padiskutuar ndonjëherë, aq më tepër në rrafsh të feminizmit a lëvizjes së tyre mbi kontributet kulturore apo rikuperimin e teksteve të shkruara prej tyre.

Ne kemi një Ana Frank që na la një ditar unik, me vuajtjet në internim. Është Drita Çomo – ku, siç duket, universi ka ligjësitë e veta të përkimeve për të konfirmuar një sublimitet që ekziston te gratë, siç është ajo e "pjesës së errët" ku nuk hyn askush, as edhe një burrë. Ndërsa modelet që vijnë nga historia jonë e letrave janë një përpjekje, por jo një rast i pastër shkrimtareje. Musine Kokalari është gruaja që dëshmoi rezistencën intelektuale, më shumë se një shkrimtare, edhe pse nisja e saj qe totalisht formim letrar e sot ndoshta do kishim studiuesen *par excellence* në letërsi, krahas krijimit.

Prej asaj kohe përballjet e grave që shkruajnë poezi a prozë duket se kanë qenë një imagjinatë e pamundur për të pasur gjithë arsyet e mundshme përse shkruajnë.

Shumica besojnë se librat e shkrimtarëve burra shprehin shqetësime universale, ndërkohë që librat e grave konsiderohen shumë më të ngushta, duke mos pasur hollësi të nevojshme për të angazhuar mendjen cerebrale të meshkujve.

Po t'i referohemi një shifre të thjeshtë që prej titujve të rinj të vitit 2018 janë shkruar mbi 10 libra nga shkrimtarë burra dhe 6-7 libra nga autore femra – ku, sigurisht, bëhet fjalë për emra të njohur në prozë e poezi, si: Mimoza Ahmeti,


Mira Meksi, Flutura Açka, Diana Çuli, Entela Tabaku, Belfjore Qose...

Disa mendime se gratë shkruajnë më mirë lidhen ndoshta me rolin e tyre në shoqëri, të cilat kuptojnë e shohin me qartë natyrën njerëzore, vlerësuar si domosdoshmëri nëse dikush po përpiqet të krijojë karaktere autentike. Duke qenë se pritjet krijimi i familjes prej saj, po ashtu dhe në drejtimin e punëve të shtëpisë në raport edhe me pritjet ndaj saj në shoqëri, për atë që gratë duhet të jenë, ato si duket krijojnë një zotërim më të mirë në kompleksitetin njerëzor.

Është pothuaj një deklaratë klasike, që njihet prej burrave për moszotërimin e grave, vështirësinë për t'i kuptuar ato, shpesh paralelizuar edhe me zotërimin letrar.

Te shkrimtarët meshkuj, veçanërisht të rinj, takohet më shumë mendimi se janë ata të rëndësishëm, jo librat e tyre, pra janë më shumë të obsesionuar pas reputacionit...

Kujtoj Markezin kur shprehet se në rininë e tij librat e parë ishin të mbushur me intelektualizma e teorizime letrare dhe kthesën e parë nga ky fenomen e pati kur shkeli në vendlindje, aty ku kaloi fëmijërinë. Nëse shkrimtarët meshkuj gjithmonë e shprehin madhështinë e tyre, siç duket, gratë thjesht preferojnë të trajtohen me respekt, puna e saj të gjykohet mbi meritat e saj dhe jo nëse ADN-ja e saj përmban dy kromozome X ose një X dhe Y. Një gjë të fundit: do ishte e vështirë sot t'i përgjigjen pyetjes se kush është shkrimtari më i mirë në Shqipëri? Ndoshta edhe e lehtë. Ndoshta edhe një grua...



Dita e Verës vjen nga thellësitë e shekujve iliro-arbëreshë. Ajo është festë e gjithë trojeve shqiptare.

Më 14 mars, edhe në Skrapar të gjendesh, edhe mes Labërisë, në kodrat e Filatit e në Lug të Drinit, do të zgjohesh me tringëllimën e zileve e të këmborëve.

Dita e Verës është festë e ripërtëritjes së gjithësisë, e gjallërimit të natyrës dhe e vazhdimësisë së jetës.

Edhe pse Shqipëria feston mbarë Ditën e Verës, kulti i kësaj dite të shenjtë tempullin e vet, gjithë motit, e ka pasur në rrethinat e Elbasanit, sepse qysh hejrit në këto anë ndodhej ajo faltore e dëgjuar e Zanës së Çermenikës (Diana Candaviensis). Dhe të gjithë e dinë se Perëndesha Dianë mbahej, në kohë të lashta, si hyjneshtë e gjuetisë, e pyjeve dhe e gjithë natyrës.

Në botën antike pastaj u nda veç një shekull i tërë, kur adhurimi i kësaj perëndeshe u përhap jo vetëm në hapësira ilire, por ç'merrnin brigje mesdhetare, në të katër anët. Aq e vërtetë është, sa shprehja “Të shitoftë (të shigjetoftë) Zana” u përdor dhe përdoret ku banojnë çqenë ilirë... Ndërsa statuja të Zanës në mermerë të bardhë u zbuluan jo veç në Apolloni, por edhe në Brigjet e Afrikës së Veriut e në Azi të Vogël, me atë emërtim të qëlluar: “Diana Candaviensis.”

Në mijëra vjeçarë, nëpër trojet tona vërshuan urdi të ndryshme të huaja, të egra. Shqiptari u mundua të ruante identitetin kombëtar. E midis gjithë këtyre rrebesheve, mbajti me xhelozë Ditën e Verës dhe e solli deri në kohën e sotme.

Bizantinët e rrethuan këtë festë me të kremtet e tyre: Llazorët e Vangjelizmojnë. Shqiptari i kujtoi sa i kujtoi këto ditë, por erdhi një çast dhe u harruan.

Dita e Verës, festa e pranverës shqiptare dhe gjallërimit të kombit, erdhi e bukur, e pastër, deri të ne.

Kjo trevë e Elbasanit, që këtij riti i pati dalë zot nga kohë që s'mbahen mend, shndërroi të gjithë rrethinën e vet në tempull, ku njeriu i falej veç një kulti: Bukurisë madhështore të natyrës, ku gjente mishërim Perëndia Shqiptare. Sa e sa faltore shpërndareshin nëpër skajet e këtij trualli. Manthioja e stërlashtë me Rrapin e Mansit degëgjërë, me burimin ujëkulluar, vendosur në krye të vendit. Gjithë ullishta e blertë, me atë çukë të famshme, tek Ulliri i Qejfit. Shëngjoni i madhërishtë, çaire e bahçe rreth e rreth. Lugina e Shkumbinit, me gurrat, te Rrepet e Byshekut. Kroi i Kalit e Burimi i Ali Xhinsit. Teferiçi e Çesmja e Lepurit. E ç'të numërosh më parë nga gjithë ato perla të kurorës hyjnore të Elbasanit-fron perëndish?!

Të merrje për Ditë Vere rrugën e Shën Thanasit, do të shihje faqen e “Tre Mullinjve” që zbardhte nga

DITA E VERËS

Nga Hyjni S. Ceka



Skicë nga Bujar Kapllani

napat e zonjave të rënda, se nuk mbetnin gra e vajza nëpër shtëpi atë ditë të Festës së Madhe. Kremtonin të gjithë dhe gëzonin të tërë.

Faik Konica, tek shkruante për Ditën e Verës në “Albania-n” e tij, kësaj i gëzohej më tepër, emancipimit të gruas që shfaqej me bukuri të veçantë, kësaj të kremteje...

Gjithë kjo, shpjegimin e ka po te Kulti i Zanës, tek ajo perëndeshë që kishte dalë nga radhët e femrave ilire. Fronit të saj shqiptarët i janë nënshtruar me bindje, gjithë jetën. Aq e vërtetë është kjo, sa që te ne s'kishte shtëpi pa oborr, e çdo oborr me lule gjithfarë. Lulishtare qenë veç nënat e Elbasanit. Nëpër Elbasan, çdo derë të çelje, grahte aromë lulesh. Gratë i rritnin të gjitha. Dhe ato net kur hëna përtërihej, gocat dilnin e këmbenin bitme lulesh, lagje më lagje. Kulti i Zanës i shërbeu femrës shqiptare të sfidonte “sheriatin”. Ajo qe përherë e lirë dhe e respektuar, si, ndryshe, në vendet e tjera, ku gjeti përhapje islamizmi.

Dita e Verës e qytetit të Elbasanit mbetej festë unikalë, vetëm e vetëm e kësaj treve, një rit që kremtohej sipas kodit tradicional, me zakone e norma të veçanta, me këngë motmoti, me formula e dogma, që vinin nga shekujt iliro-arbëreshë.

Mbi të gjitha e të gjitha, Dita e Verës shpaloste adhurimin për “Nënë Natyrë”, për PJELLORINË e saj, për begatinë dorëlëshuar... Prandaj qe personalizuar me gjyshen, me nënën, me nusen...

Për këtë ditë ruhej e gjithë zahireja e motit të shkuar: palët e fikut dhe arrat, mollët e ftonjtë, mjalti e pekmezi...

Rituali niste me një ditë përpara, me bërjen e revanive (ballakumet u futën më vonë).

Ishin të posaçme enët dhe mjetet e kësaj ëmbëlsire. Nuk mund të quheshe “zonjë shtëpie”, pa njohur recetën e saj. Mënyra e rrahjes, pastaj, përbën atë teknikë që e lë këtë specialitet veç patentë të “zonjave” elbasanase.

Si në çdo rit, në gatim zbatoheshin e pëshpëritheshin formula, se merrej mësysh e përfletej ëmbëlsira, prandaj as në furrë s'çohet. Piqej në shtëpi, me saç.

Çdo fazë e gatimit të revanisë shoqërohej me thithje buzësh, që jepte fishkëllimë karakteristike. Largonte “qoftëlargun”.

Heqja e fundit e saçit ishte çast i rëndësishëm. Revania e pjekur, e ardhur-ogur për së mbari. Revania tuç-shenjë e keqe. “Qoftëlargu” e kishte prishur me anën e “syrit të lig”.

Darka e Ditës së Verës kishte solemnitetin e vet. Ajo mbrëmje pritej me padurim se do të sillte “dhuratat e Hyjit”. Shtrohej “sofra e madhe” dhe ekspozoheshin pjesët (hiset). Barabar “hiset”, të tëra, ndarë me dorë në zemër, me drejtësi providenciale. Nënkuptohej që këto “pjesë” përbëheshin nga ballakumet, palat e fikut dhe arrat, dhe ato që ishin karakteristike, kofshët e gjelit për brezin më të ri.

“Madhja”, zonja e madhe, më plaka e shtëpisë,

që personifikonte Pjellorinë, merrte atë mbrëmje një nur shenjtërie të veçantë. Ajo do ta kalonte tërë natën zgjuar. Shkonte dhomë më dhomë e shtrat më shtrat, vendoste gjelbërim të ri, mbi jastëkë të çiftëve, të të rinjve e fëmijëve, rit që nënkuptonte ripërtëritjen e gjallërimit. Plisa prej bari të njomë qenë vënë dhe mbi tjegulla të avllive dhe mbi strehë të portave të shtëpive.

Festa niste me zgjim të hershëm, larë e pastruar. Zinte fill me veshje të reja të pranverës, pajisjen e fëmijëve me “verore”.

Ç'ishte VERORJA?

Distinktiv i pjesëmarrësve në ceremoninë e Ditës së Verës.

Ajo përbëhej nga dy fije kuq e bardhë prej leshi. Gjak i kuq gjallërues, në moshën e bardhë të brezit të ri.

Nga ana tjetër, verorja ngjizej me besëtytninë e fuqisë mbrojtëse nga e liga. Ajo mbronte nga sëmundjet e të marrët mësysh, pra, njëfarë shenje simbolike, po arkaike fort, sepse mendja ma thotë se vinte nga kohë prehistorike, kur s'ka qenë përdorur shkrimi i nuskave dhe i bulave priftërore.

Gjithçka duhet të shprehte se “dimri qe me cule e vera vjen me lule”, me veshje të hijshme... Plogështinë, papastërtinë, sëmundjet... i kishte marrë dimri me vete.

Dhe prapë... çdo sjellje, çdo lëvizje, makar, edhe çdo fjalë, të ishte e gjallë, e vëmendshme, e arsyeshme. Kryesisht, fëmijët dhe adoleshentët duhet të ishin me përgjigje majë gjuhe.

Ka qenë një tjetër rit që i vinte në provë fëmijët.


Në rast se të thirrurave nuk u përgjigjeshin me “urdhëro” të civilizuar, atëherë nëmeshin me formulat: “Marrsh morrat e pleshtat! Gjumin e sabahut! Ethet e verës! Me çekiçë derës!” Një fjalë goje, marrë sot, po ato kohëra ishte shuplakë e rëndë që lëndonte shpirtërisht. Njëkohësisht, mjet korrigjues për ata që s'qenë mësuar me fjalor qytetar e zakone sjelljeje të moralit tradicional!

Duke u thelluar sot në trashëgiminë që sjell Dita e Verës te ne, për as edhe një çast nuk duhet shkëputur mesazhi i saj thelbësor që gjendet në nderimin ndaj burimit të pjellorisë. Dita e Verës i falet Nënë Natyrë-Zanës Mitike, po gjithë këtë filozofi e konkretizon me një respekt festiv ndaj nënës e fëmijës, ndaj gjysheve, pikësëpari, ndaj mëmave, nuseve, të fejuarave... Atyre që lindin njeriun.

Më së miri për këtë dëshmon KAMA.

Në ritualin e Ditës së Verës, KAMA-TË BËRËT KËMBË shënonte solemnitet të veçantë. Është detaji që dallon kremtimin elbasanas të motmotit, nga gjithë festat që i kushtoheshin pranverës në Shqipëri e gjetkë.

Gjesti i KAMËS rreh të dëshmojë vëmendje të posaçme për të forcuar e mbajtur në vazhdimësi lidhjet mes brezave e krushqive. Dhe kryhej ky veprim me kujdes skrupuloz deri në fanatizëm që KAMËS i jepte shenjtërim të veçantë.



KAMA-TË BËRËT KËMBË është procedimi i të shpërndarit të “hiseve” nëpër krushqi. Si protokoll përbën një traditë të stërlashtë, me kohë e norma fikse të një trashëgimie vetëm iliro-arbëreshe.

Çonte për të bërë KAMË në derë babeje nusja e shtëpisë. Por KAMË çonte edhe zoti i shtëpisë, kur ndodhej ndarë më vete prej pleqve.

Për KAMË dërgoheshin fëmijë, gjenerata më e re, djalë ose vajzë. Shkonte një, por edhe bashkë, kur të vegjlit vinin njëri pas tjetrit. Dhe në rast se nëna e fëmijës do të kish vdekur, prapë i vogli dërgohej nëpër gjyshër dhe më i përkujdesur.

Në prag të derës së gjinisë futej këmba e djathtë. Ndoshta prej kësaj edhe riti quhej TË BËRËT KËMBË.

Me shumë gjasa, emërtimi KAMË i këtij procedimi vjen nga fjala “cambio” e latinishtes, huazuar qysh hejrit në gjuhën tonë. Pra, “këmbim”, ndërrim... Për këtë të dytën bindemi më shumë, sepse dërgohej “hise” dhe merrej “hise”. Palët konkurronin mes tyre, kush e kush të dërgonte “hise” më të majme. Nënkuptohej, gjithë “menyja” e kompletuar e Ditës së Verës, me revaninë karakteristike, simitet e kuqe, pemët e konservuara, pilafin me gjel, sheqerin e kuq.

Pleqtë në këtë anë siguronin nëpër hise dhurata karakteristike për gjeneratën më të re. Kështu, p.sh., duheshin aq kofsha gjeli sa nipër e mbesa kishin. Nënkuptohej, aq gjela deti siguroheshin për Ditën e Verës.

Veç KAMËS tipike, për Ditë Vere bëhej edhe një KAMË tjetër, disi e veçantë. Ishte këmbimi i dhuratave midis të fejuarve. Dera e dhëndrit dërgonte “copë” për fustan, arturina dhe sheqerka. Shtëpia e nuses kthente me jelek e të brendshme dhe shami dore për të fejuarin. Sigurisht, këto dhurata nuk dërgoheshin prej të vluarve, por prej një djali të vogël të shtëpisë, shoqëruar prej dadosh që mbanin shtëpitë elbasanase të atyre kohëve.

Dita e Verës e Elbasanit, çuditërisht, sjell në ditë të sotme traditën e saj të Kandavës ilire. Ngjyra panairike, pelegrinazhi dhe Rrapi i Mansit, trevë ku zhvillohej kjo festë, tregojnë më së miri për një ceremonial të hershëm, për një religjion, që si kult të vetëm pati Zanën e Kandavëve... Diana Candaviensis.

Shkencëtarët tanë shpjegojnë se te MANSI i sotëm kemi MANTHION antike, stacionin e famshëm të EGNATIAS, që priste e përcillte udhëtarë e pelegrinë, të cilët vinin në SKAMPIN për t’iu falur Dianës së Kandavëve, si vend ku gjendej edhe tempulli i saj.

Ai Rrapi i Mansit, me kroyin e pozicionin karakteristik. Si amfiteatër natyror, ma do mendja të ketë shërbyer nëpër vite për t’i mbledhur fiset e arbërve rreth Hyjneshës Dianë apo Zanë të Kandavëve, sikur u kanë pasë thënë së lashti, çermenikasve.

Manifestimet popullore që jepeshin deri në mes të shekullit tonë në sheshet rreth Mansit, tek Tyrbja e Shutrit e gjetiu, sollën deri te ne shfaqjet me maska e rituale të veçanta që kanë gjurmë të teatrit të antikitetit. Vallet e këngët, e gjithë ajo larmi kostumesh që ekspozohesh, prapë dëshmon për një çast të hyjnizuar.

Në kohët moderne, nga Rilindja e këtej, të parët tanë elbasanas ruajtën Ditën e Verës duke e kthyer atë në një festë gjithëkombëtare, me tempull në trojet e Skampinit të lashtë. Ndërruan kultin e Zanës dhe vendosën në fron hyjnor SHQIPTARIZMIN e të gjithë shqiptarëve. Dhe vit për vit Elbasani pret pelegrinë që vijnë për t’u bërë së toku e për t’iu falur Zotit të Arbërve.

Përmendim këtu Ditën e Verës të 14 marsit 1943, në thellësi të Ullishtës, te Kroj i Kalit; duke iu falur Perëndisë së shqiptarëve, u lidh në besë gjithë populli në luftë kundër fashizmit.

Përmendim 14 marsin e vitit 1944, e vetmja Ditë Vere që nuk u festua në gjithë historinë e këtij qyteti, sepse pushtuesit e përgjakën të kremten e shenjtë me gjak dëshmorësh dhe masakrën e kryen po në shtegun ku shkohej për në tempullin e RRAPIT TË MANSIT.

Përralla/ Nga libri “Erotikoni e satirikoni” i Virgjil Muçit

RRËFENJA E NJËZETEPESTË OSE MË E DOMOSDOSHME KRIPA SE MJALTI

Ku i biri i jep një mësim të mirë së ëmës se ç’është dashuria për nënën dhe se si nuk duhet ngatërruar me ndjenjat që ushqejmë për të tjerët

Nga Virgjil Muçi

Në kohë të vjetra jetonte një vejushë tok me të birin e vetëm, të cilin e rriti me thërrime dhe dashuri, me gjithë dashurinë që një grua e mbetur fillikat, njeri pa njeri, mund të hedhë mbi djalin e vetëm. Erdhi koha që djali u poq e u bë burrë dhe pa e zgjatur, u martua e mori një vajzë nga derë e mirë. E ëma ishte një grua zemërmirë, por mendjecekët, dhe ngandonjëherë bëhej smirëzezë kur shihte dashurinë e të birit për të shoqen. I ngrihej mendja dhe pandehte se i biri nuk e donte më dhe gjithë dashurinë e kishte hedhur mbi gruan.

Si shkuan ca kohë, teksa po rrinin një natë pranë zjarrit nënë e bir, hidhet nëna dhe e pyet:

- O djalë, më kallëzo të drejtën, qysh më do ti mua?

Djali e kuptoi aty për aty se ku rrihte të dilte e ëma dhe ia ktheu thjesht e shkoqur:

- Të dua, o nënë, si kripën.

Po gruaja e moshuar nuk u ndal me kaq dhe e pyeti sërish:

- Po tët shoqe, qysh e do?

Djali shtiu buzën në gaz. “Ah, më dole në shteg”, - tha vetë me vete. Dhe u përgjigj e i tha:

- Gruan e dua siç duhet mjalti.

U hidhërua e u bë pikë e vrer gruaja plakë kur dëgjoi ato fjalë nga goja e të birit dhe pa i folur me gojë, shkoi i ra në shtroja.

Të nesërmen në mëngjes, para se të dilte në arë, i biri i porositi të ëmën dhe të shoqen të gatuanin për drekë këtë e atë gjellë, por të mos u hidhnin kripë, dhe bashkë me to të shtronin në sofër edhe një pjatë mjaltë. Gratë shqyen sytë e u çuditën nga ajo kërkesë e pazakontë, por, gjithsesi, nuk bënë llafe. Pas porosisë që u kishte lënë burri i shtëpisë, përgatitën gjellët e i shtruan në tryezë dhe së fundi, zbritën në qilar e mbushën një pjatë plot me mjaltë, që e vendosën pranë hajeve të tjera.

Kur u kthye nga puna, djali u shtrua në tryezë, por ç’të fuste në gojë e ç’të hante i ziu! Megjithëqë e ëma dhe e shoqja qenë munduar të gatuanin sa më mirë e t’i bënin gjellët sa më të shijshme me erëza e gjithë të mirat, pa një kokërr kripë ato s’futeshin në gojë. Pa ç’pa iu


kthye pjatës me mjaltë dhe hëngri sa u shqep, por kur u ngrit nga tryeza që të shpëlante duart e gojën, iu duk sikur s’kishte ngrënë gjë prej gjëje.

E ëma dhe e shoqja po e shikonin me sy të çakërritur se s’po kuptonin gjë prej gjëje. Ç’dreqin kishte ndër mend që po sillej ashtu? Ç’i thoshte vallë koka? Një gjë të tillë nuk e kishte bërë herë tjetër.

Pas buke, i biri u soll nga e ëma dhe i tha:

- A e pe, o nënë, që gjellët pa kripë nuk futeshin në gojë? Mjaltin që është i ëmbël e hëngra me ëndje, por, kur lava duart e gojën, ëmbëlsira vajti e shkoi dhe tani më ngjan sikur nuk kam ngrënë fare. Pra, siç e sheh, është më e domosdoshme kripa se mjalti.

Gruaja plakë u gëzua shumë kur dëgjoi ato fjalë dhe vetëm atëherë e kuptoi se sa e marrë ishte treguar që kishte vënë në dyshim dashurinë e të birit. Qysh nga ajo ditë s’e hiqte nga goja të birin për dashurinë dhe mençurinë e rrallë.



MË MIRË TË QAJ NJË DITË SE ÇDO DITË

Nga Rexhep FERRI



1.
Në kohë lufte...
Me çmenduri në çmenduri.
Një vajzë gjashtëmbëdhjetëvjeçare e dhunuar.
E pyet veten:
- Po sikur të mos kisha lindur çikë, e sikur të mos isha gjallë?!
Ajo ende nuk kishte pasur një fotografi të një të dashuri...
Priste moshën kur vajzat rriten! Deri tek mendja i thotë:
“Shiko sa je rritur” dhe pyete veten: “Ku po të shkon mendja!”
Ajo vajzë për të dalë nga rrethi tragjik e për ta mbrojtur veten edhe nga vetvetja, shpesh ndalet.
Pyet veten:
- Çka të bëj me vetveten?
Pse nuk u fsheha nga kriminelët?
Rrugës si u ngatërrova?
Pse nuk u bëra e padukshme?
Më mirë ta kisha thyer qafën.
Estetika e mjerimit kujt i flet?!
Nga kjo histori e errët paskam lindur për t’u dhunuar nga bishat.
Si për ironi të fatit, asgjë nuk dimë se çka na pret.
Ndodh ajo që ndodh.
Deri atë ditë që veten e pashë në gojë të ujkut, bota

ishite bota e lumtur edhe për mua.

Tani për çka të jem e fortë. Më mirë të qaj një ditë se çdo ditë...

2.
Për njerëzit mendjebardhë, nëse ka ende njerëz mendjebardhë...
Gjatë luftës e pas luftës, me njerëzit zemërzi jeta është e zeza jetë.
Tregon tmerrret dhe humbjen e çdo vlere njerëzore.
- Edhe për grykën e topit është çmenduri.
- Kur Bishat më kapën të gjallë dhe bënë çka deshën me mua nga paniku i shpejtë pse nuk humba? Pse nuk u bëra e padukshme për të ikur e për të mos rënë në duart e bishave? Zotin e kam dëshmitar. Jashtë mendjes ndihem pak si fajtorë. Kur jeta bëhet e rëndë.
Nga lufta në luftë, rrethana fatkeqe nuk është ndjenjë e hidhërimit, por plagë e hapur, e thellë sa varri i hapur.
Kur errësira ma humb mendjen, krimet nuk po më lënë as të vdes e as t’i harroj krimet.
As tani nuk po i themi të gjitha.
As që do të thuhet ndonjëherë.
Kam varrosur shumë ëndrra të djegura para se të lindin...
Është e pabesueshme për ta kuptuar.
Plagët janë të thella.

Zemër, më fal!
Mos më kërko larg.
Larg isha kur isha!
Nga bota në botë, Zoti më ndihmoftë që të ruhem edhe nga vetvetja.
Tani, besoni, nuk do ta vras veten.
Ku do të shkoj nuk e di...
Ndoshta nuk do të ketë gjak.
Ka humbur frika.
Për faqezinjtë turpi ka vdekur.

3.
Për sot askush nuk mund të përgjigjet çka ndodhur e çka mund të ndodhë.
Prapë po ju them:
- Besomëni se nuk do ta vras veten. Po kërkoj besimin që më bën të fortë. Të jem e fortë dhe të di arsyen pse të jem e fortë. Jeta nuk e di si na vjen dhe si na humb.
Zemër, më fal!
Po ndalem pak të mendoj çka të bëj me jetën.
Mundem vetëm me treguac se ajo çka deshën e çka bënë me mua bishat kurrë s’më hiqet nga mendja.
Ishte tmerr.
Tani plasi nga inati pse linda femër.
Nga lufta.
Nga tmerrri.

Historia e monodramës “Dome” është një histori sa suksesi aq edhe dështimi.

“Dome” është një tekst i shkruar enkas për aktorin e teatrit “Migjeni” të Shkodrës, Enver Hysenin. Shkrimi i saj është produkt i një vëmendjeje të zgjuar gjatë bisedave të gjata me aktorin ndër procese pune apo ndenje të rastësishme. Ajo që më ka bërë përshtypje gjatë këtyre bisedave, ka qenë gjithmonë sinqeriteti i thellë me të cilin Enver Hyseni tregonte aspekte të ndryshme të jetës së vet, që rrinin të lidhura ngushtë me epokën së cilës i përkisnin. Më ka përshtypur gjithashtu edhe thjeshtësia e tregimit, veçanërisht mungesa e mlllefeve dhe inateve. Si çdo person tjetër, edhe Enver Hyseni e ka jetuar kohën e vet herë ndër margjinat e herë në kryeradhë; e ka jetuar brenda tragjizmit dhe komikes; e ka jetuar në varfëri dhe në lavdi; vetëm dhe me shokë; me mish e me shpirt. Pra, kam dashur të shkruaj dhe më vonë të ndërtoj një shfaqje të thjeshtë, “shfaqje aktori”, një shfaqje që të ngjasojë si një akt rrëfimi, pse jo edhe kërkimi ndjesë, pardoni, si një gjest që kaq shumë i mungon shoqërisë sonë. Kam dashur t’i qasem prej së afërmi teatrit dokumentar.

Dhe vendosa t’i përgjigjesha thirrjes për projekte që kishte shpallur Bashkia e Shkodrës në fund të vitit 2017. Hartova për këtë punë një dosje të plotë, duke plotësuar të gjitha kërkesat në respekt të nivelit të nderit të atij komisioni vlerësues. Futa brenda tekstin, platformën regjisoriale, skicat skenografike, disa shënime motivuese dhe gjithçka tjetër që duhej për

“DOME” PATI NJË LINDJE TË VËSHTIRË...

Nga Stefan Çapaliku

t’ua bërë sa më vizibël zotërinjve dhe zonjave të këtij këshilli shfaqjen e ardhshme.

Dhe duke bërë këtë gjest, kohë më vonë kuptova se po bëja një nga gabimet e radhës të jetës sime, që nuk janë të pakta. Pra, me dy fjalë, po dorëzoja nderin tim profesional në duart e disa personave që, në përgjithësi, kishin lidhje të tërthorta me Teatrin. Kujtoj këtu se komisioni përbëhej nga dy profesorë letërsie, një historian arti, një skulptor, një mësues i edukimit fizik, një zonjë (me gjasë juriste), të gjithë të mbledhur në zyrën e Kulturës së kësaj bashkie, kryesuar nga një tjetër zonjë (me gjasë ekonomiste).

Dhe, në fakt, asnjë përgjigje zyrtare nuk më erdhi prej atij komisioni. Në formë thashethemesh mora vesh se projekt-propozimi nuk qe miratuar, përveç të tjerash, edhe për faktin se një ekip “specialistësh” nga Teatri kishte shkuar të kontaktonte me komisionin në

fjalë, duke dhënë një dorë të mirë në dobi të kauzës së mosmiratimit.

Kurioz për mosmarrjen e një përgjigjeje zyrtare, më në fund, mësova se përgjigjen duhej ta gjeja diku në faqen zyrtare të Bashkisë. Pra, ideja ishte se unë duhej ta lexoja përditë këtë faqe, derisa të gjeja lajmin e keq. Ky proces do më vlente në kalitjen e durimit. Por meqenëse unë nuk jam durimmadh, i shkrova gati një vit më vonë dhe prapë nuk mora përgjigje. Pra, drejtorja në fjalë përtonte t’i përgjigjej dosjes sime me dy rreshta. Kërkova procesverbalin e mbledhjes dhe nuk ma dhanë kurrë, aq sa u binda se nuk ka pasur një të tillë. E vetmja gjë që mësova me siguri, ishte që propozimi im qe mbrojtur nga i vetmi person që merrte vesh nga teatri, një studiues i shkëlqyer i dramaturgjisë kombëtare, dr. Gëzim Puka. Kështu që mbas një viti nga refuzimi i Bashkisë së Shkodrës dhe mbas katër

Nesër nuk e di si do të zgjohem.
 Për të shpëtuar nga dhunimet e kriminelëve të droguar edhe ëndrrat po më çmendin.
 Zemër, më fal!
 Duhet të bëhem e fortë.
 Edhe pse nuk e di për çka duhet të bëhem e fortë.
 Me pak shpresë çka na sjell jeta?
 A ka përkrahje morale më të fortë se ballafaqimi im me dhimbjen time të thellë?
 Të menduarit më vret.
 Heshtja edhe më shumë më vret.
 A e di se çka ke humbur, shpesh i kam thënë vetes...

4.
 Ne flasim, por fjalët nuk i gjejmë.
 Përpiqem të ndihem e gjallë. Për kohën që shkon, për kohën që kthehet, kur njerëzit e cirkut të kësaj bote nxjerrin flakë nga goja.
 Nesër nuk e di ku do të shkoj. Jeta qenka edhe humbje e papritur. Dhe shkurt, përsëri e njëjta gjë.
 Zjarr. Luftë. Zhgënjim.
 Më lejoni t'ju kujtoj se mashtrimi është një lloj përralle që na qet në gjumë.
 Dështimet.
 Zhgënjimet.
 Mashtrimet.
 Hakmarrjet.
 Nga dështimet vetëm tregtarët patriotë nxjerrin përfitime.
 Me ligje e pa ligje, vetëm në letër.
 Drejtësia funksionon.
 Vdekja fizike dhe vdekja morale janë në krizë.
 Lufta është frikë.
 Jeta e pashpresë edhe më e frikshme.
 Mos e kërkoni kodin për ta kontrolluar kujtesën.
 Kujt t'i besojmë?
 Për mllafe dhe probleme me drejtësi e kemi heshtjen.
 Ajo na tregon se kush jemi e ku do të shkojmë.
 Nga këndi tjetër mos kërkoni falje!
 Nuk po e di si t'i kthehem prapë jetës.
 Kujt t'i besoj?
 Jeta ka shumë vuajtje, lakmi.
 Krimet edhe në thellësi të oqeanit janë të ngjashme.
 Tani për çdo pikë gjaku është vonë të flitet.
 Për të folur duhet të kërkojmë vështrimin e shpejtë të aparatit fotografik.

Aty kur nuk arrijmë ta shohim fillimin, tragjeditë vijnë dhe shkojnë si përsëritje.
 Megjithatë, diku thellë në ne prapë na vjen të shpresojmë.
 Në pritje të një ëndrre mashtruese na gjen fundi i shekullit.
 Për të shkuar deri në fund, drejtësia nuk gjen fjalë.
 Rasti mbyllet.
 Kriminelët ndërrojnë maskat.
 Ligjet si drejtësi më shumë u besojnë gënjeshtreve se së vërtetës.

5.
 Tani, si në përralla, pak jam në këtë botë e pak në botën tjetër, që nuk e njoh.
 Nuk e di as se ku është e sa është.
 Nga kjo largësi, pas shtatëmbëdhjetë vjetëve, vajza e dhunuar nga kriminelët e luftës çka mendon, e pyet pasqyrën.
 Ajo i thotë:
 - Largësia nuk ka largësi. Ka kohë. Jetë dhe harresë... Sa herë të më pyesësh, prapë ta them se jeta është edhe harresë, edhe e papërsëritshme.
 Për t'ia hedhur një sy së nesërme, ngjashmëria sa është e mirë dihet.
 Është largësi që njeriu me vete e sjell në jetë.
 Siç po e shoh në horizont, harresa është gjë e mirë.
 Për fjalën që do shpirt, mundësia për ta takuar edhe një herë veten, për një të ardhme, për një të shkuar nuk e kemi heroin e ditës.
 Në histori dhe jo në histori pashë një patriot sojli të veshur si grua, si plakë. Pa therë në këmbë shpëtoi nga kriminelët e luftës dhe doli në Shqipëri.
 Pas tri ditësh e takova në Tiranë.
 Nga fjala e tij kuptova se çka na ka gjetur dhe ku do të shkojmë. Gjithmonë janë tri kohë. Vetëm njëra është për ne. Për të gjetur një zgjidhje ajo dritare e vdekur mbyllet dhe hapet me fatin tonë.
 Ta ruajmë ose ta harrojmë.
 Çka na duhet koha e ardhshme pa kohën e ardhshme.
 I lumtur dhe i shëmtuar jeton vetëm djalli.

6.
 Për mua origjina e njeriut është botë e dyshimtë.
 Botë e panjohur.
 E kuptojmë si dhuratë prej Zotit kur është edhe në fund të detit.

Tani nuk dua të mendoj asgjë më shumë.
 Nga jeta me frikë asgjë nuk kërkoj.
 Dal në dritë kur dita zgjatet edhe për një ditë.
 Sot askush nuk mund të përgjigjet:
 Çka na pret?
 Çka na merr?
 S'ka frikë që na tregon.
 Ajo që na del përpara është një realitet që na urren dhe që e urrejmë, të cilën gjatë udhëtimit diku e harrova.
 Edhe rrugën e lashë përgjysmë.
 Rrugën që ia kisha premtuar vetes.
 Në flakë dhe gjithçka tjetër nuk po më kujtohet.
 Nga tmerret e kriminelëve të luftës, në një pullë postare pashë:
 Nëna;
 Gra;
 Motra të dhunuara e të lëna në stom të rrugës lakuriq.
 Pyeteni veten:
 Ku?
 Pse?
 E kur?
 Një ushtimë që vinte nga larg më tha:
 “Pse s'po guxon me shkue në luftë? Mos po frikësohesh se e vret anmikun?”
 Unë mes Shpirttrave të vdekur u ndala.
 Te Guri i varrit të nënës më lëshuan këmbët.
 U rrëzova.
 Nuk më dhimbset jeta as sa një cigare e duhanit.
 Nga zemra e plastë, thashë.

7.
 Harresën po e marr si po.
 Do të jam në kërkim.
 Ta provoj.
 Zgjohem nga e kaluara.
 Sipas legjendës, kthehem nga mejdani me nëntë plagë.
 Duhet të më ndihmoni me praninë e gjallë.
 Kur mbesim pa fjalë. Nuk e di sa mund të jam e fortë.
 Për diçka që ka ndodhur, moralin e gjej te lindja e njeriut.
 Lufta nuk fitohet pa shkuar në luftë.
 Ajo i takon zjarrit për të jetuar.

Shkurt 2019

vjetësh nga data e shkrimit, monodrama “Dome” u prit si nga një mami e panjohur nga Teatri Kombëtar Eksperimental në Tiranë.

Kështu që “Dome” nisi të sillet nëpër skenën e Tiranës me një valixhe në të cilën kishte sistemuar me kujdes gjithë jetën e vet. Jeta e tij mundej me qenë edhe diçka më e vogël se ajo valixhe, por atij kështu i pëlqente. Sepse duhet ta dimë që ka njerëz që nisen për të shkuar në atë jetë edhe me duar ndër xhepa. Por Enver Hyseni e kishte marrë seriozisht që ta përballonte burrnisht fundin e karrierës së vet, tashmë në një qytet që nuk i përkiste, si Tirana. Kësisoj, ai dëshmon se është një figurë deheroizuese dhe që e merr të gjithën si lojë. Si një lojë shpesh e luajtur pa rregulla e pa arbitër. Enver Hyseni ose “Domja” ime ka shitur gjithçka, përveç shpirtit e nderit. Ai e ka kuptuar më thjesht se shumëkush tjetër se të gjithë ne jemi aktorë dhe se madje aktorët që nuk luajnë në teatër janë ku e ku më të zotë se ata që marrin rrogën për të interpretuar. Pra, “Dome”, ashtu si pa dashje, u paraqit si një hero i kohës sonë. Sigurisht që në atë rrëfim jam edhe unë. Unë kam kryer një akt postproduksioni duke i montuar copat e jetës së “Dome”-s në një ritëm dramaturgjik që ndjek disa rregulla, si suspansat, kulminacionet, shpërthimet agresive e humored e pauzave vepruese.


Kështu që “Dome” e mirëpritur tashmë nga Teatri Eksperimental u prit në Tiranë me një valë duartrokitjesh të pambarimta dhe korri kështu një sukses larg parashikimeve tona, sidomos larg parashikimeve të atij komisioni të nderuar refuzues që

kishte thënë se “Dome” do mund të kuptohet vetëm në Shkodër e askund tjetër.

Por ja që monodrama “Dome” erdhi në Teatrin e Shkodrës si një dështim i plotë në pikëpamje të numrit të spektatorëve. E pabesueshme, por “Dome” në tri net ka pasur vetëm 77 bileta të shitura, vetëm me 200 lekë copa. Oh, sa do dëshiroja që dikush të dilte e të na e shpjegonte këtë të vërtetë! Do më pëlqente shumë sikur dikush të dilte e të argumentonte se “Dome” nuk ka pasur spektatorë, sepse është një tekst i dobët, është regji e dobët, është interpretim i dobët apo të tria bashkë. Do kishte qenë gjithashtu i mirëpritur ai që do shkruante apo thoshte se “Dome” nuk ka pasur spektatorë, sepse në të njëjtat ditë dhe orë me “Dome”-n në qytet ka pasur një premierë filmi, një operë, një ekspozitë pikturë apo një koncert simfonik. Po kështu kishte qenë melhem fakti se shfaqja nuk ka pasur publicitetin e duhur. Por kur kujtohem se të gjitha televizionet lokale e kanë transmetuar kronikën e shfaqjes në të gjitha edicionet e lajmeve, kur mësoj se *facebook*-u i Teatrit ka mbi 5000 miq, se *facebook*-u im ka gjithashtu 2500 të tillë, kur shoh se lajmin e kanë përcjellë disa gazeta qendrore dhe portale të rëndësishme lajmesh, atëherë më rezulton se përgjatë këtyre tri netëve kanë ardhur afërsisht 0.01% e njerëzve që e kanë pasur këtë informacion.

E nëse dikush nuk del të më japë një shpjegim të arsyeshëm mbi këto çfarë po ju them, mbajeni mend se kjo atëherë do mund të lexohet si një shenjë e keqe. E keqe sa s'ka.

Kur njerëzve u vdes kurioziteti, kjo do të thotë se atyre po u vdes motivi për të qenë të pranishëm në qytetërim. Do më pëlqente shumë që të paktën njerëzit e Teatrit të vinin në teatër. Por jo. As njerëzit e kulturës nuk erdhën të shihnin teatër, as njerëzit e universitetit nuk erdhën të shihnin teatër dhe larg qoftë, as njerëzit e bashkisë nuk erdhën të shihnin teatër. Dhe ç'është më e keqja e të këqijave, as shumica absolute e njerëzve të komisionit nuk erdhën që të mund të verifikonin drejtësinë e vendimit të vet. Dhe e vërteta e “Dome”-s ndërkohë avullon. Avullon dhe kthehet prapë ndoshta.



Leximi i poezisë “Hera-herës” të Mariklena Niços

AMËSIA KU GURGULLON HESHTJA E KRIJIMIT

Nga Entela Tabaku

Poezia dhe lexuesi kanë nevojë të takohen disa herë për t'u njohur. Si takimet e dashurisë. Nëse pas takimit të parë nuk ke më dëshirë të rikthehesh, atëherë e di se nuk bën për ty. Në çdo takim mëson dhe ndien diçka të re për poezinë dhe për veten. Sa më thellë t'i hysh një poezie, sa më thellë që ajo gërmon në ty, aq më e mirë është. Për ty, si lexues.

Në këtë perspektivë leximi i parë është gjithmonë një lexim i së dukshmes, i sipërfaqes: tema (për çfarë flet poezia?) dhe gjuha poetike (çfarë e mban një poezi në këmbë figurativisht, cilat janë metaforat, gjetjet, ritmi?). Në leximin e parë vëren edhe si të bën të ndihesh kjo poezi: a të hyn në gjak, a të flet apo ta kundron botën me sytë e tjetër kujt? Poezia e mirë të rikthen te vetja gjithmonë. Asaj nuk mund t'i ikësh, ashtu si nuk mund t'i ikësh vetes.

Leximi i parë (leximi i sipërfaqes)

Lexoje, të lutem, tani poezinë “Hera-herës” të Mariklena Niços, marrë nga faqja e saj në *facebook*.

*Hera-herës
ia beh një krijesë pluhuri e drite
gjithë hir e aromë mëmësie,
Dihat e afrohet.
Ka një pus të thellë në krye
që zbret deri në mitër.
Jehojnë lutje n'shpirt
n' fyt gurgullon heshtje.
Përulet, goja e pusit ndjell humnershëm.
Bie, me ndjesi të panjohura ngjitjeje
ujëra derdhen, dritë shpërthen.*

*“Sa lehtë më ke lindur, sa heshtur”.
E pyes: “Po dhimbjet?” më thotë:
“Vijnë më pas.”*

Duhet ta pohoj se unë ende pa e mbaruar leximin e parë të kësaj poezie kam nisur ta rilexoj. Sepse, siç ndodh me poezitë që mbështeten në elemente simbolike, në çdo tast që shkel hapen ikona të reja të cilat të shpien tutje. Të gjitha leximet ndodhin njëkohësisht dhe paralelisht. Sipërfaqja dhe teknika janë të gërshetuara. Kështu e gjej veten duke menduar leximin e dytë pa mbaruar të parin. Dhe leximin e katërt e kam mbaruar me kohë.

Hyrja e poezisë është krejt e butë, prej pluhuri e drite, e përbërë nga katër vargje që fryjnë si puhizë, të mbartura jo vetëm nga domethënia e fjalëve, por edhe nga ato h h h-të e shumta:

*Hera-herës
...beh... pluhuri...
...hir...
Dihat... afrohet.*

Dhe mandej kjo metaforë e fuqishme e pusit në krye që të projekton një figurë, një imazh të veçantë në mendje. Dhe njëherësh ia di kaq për nder poetes që nuk e ka shoqëruar poezinë e vet me një foto a pikturë, siç është bërë e modës këto kohët e fundit. Sepse kjo është ndër ato poezitë që e valëvisin si flamur forcën përfytyruese të fjalës. Askush tjetër nuk

mund ta përfytyrojë dhe ta figurëzojë këtë krijesë që i afrohet poetes, ashtu siç mundet vetë lexuesi. A e sheh ti krijesën? Për mua është një qenie dadaiste që në vend të kryetit ka një hinkë me grykë të gjerë me gypin të futur thellë në trup, deri në bark. Tek ti ai pusi në krye ndoshta vjen në një formë tjetër? Forca e fjalës është e paparashikueshme. Prej krijesës emetojnë lutje dhe gurgullima. Dhe kjo figurë përulet. Si dikush që të nderon a sikur të fton në vallëzim. Dhe mandej rënia. Më pëlqen shumë kjo pavetësi e foljes “bie”. Rënia, sidoqoftë, është festive, me derdhje dhe dritë, e shoqëruar nga një ndjesi ngjitjeje.

[...]goja e pusit ndjell humnershëm – Nuk mund të rri pa e shënjuar këtë varg: goja, pusi dhe humnera. Kapërthimi i këtyre tri fjalëve, që figurativisht kanë të njëjtën formë, për të nënvizuar ndjelljen e rënies drejt mitrës ka efekt gati mistik në lexuesin. Është një rënie e lumtur, është një dorëzim i mbarsur. Tri vargjet e fundit mandej e rrumbullakosin rrëfimin. Filli i mëmësisë së fillimit rikthehet me “si më linde” dhe “po dhimbjet”. Dhe është shumë e andshme në lexim kjo poezi. Kam dëshirë ta lexoj disa herë vetëm për të dëgjuar si më endet nëpër gojë. Ndjellshëm. Dhe puhizshëm. Dhe është një poezi që më mbush me gëzim, dritë shpërthen nga kjo poezi.

Leximi i dytë (leximi i teknikës)

Leximi i dytë zakonisht nis e t'i zbulon sekretet e realizimit. Lexuesi e gjen veten duke zbërthyer teknikën e poezisë njëkohësisht që zbërthen veten. Në këtë pikë poezia duhet lexuar me zë të lartë. Lexoje, të lutem, edhe një herë. Kjo krijesë e butë dhe hhhhhh-eshme më afrohet edhe mua. Mundohem ta kuptoj si ia mbërrin poetja të ma projektojë pranë ashtu papritmas,



si një hologram nga filmi *Star Trek*. Më duket se janë pikërisht ato hhhhh-të që sikur ma transportojnë para syve krijesën. Sidomos kombinimi “hera-herës” me “beh” i jep gati një jetë hologramografike. Po kush është kjo krijesë?

Poezia rrëfen (këndueshem) se:
- është prej pluhuri e drite,
- është gjithë hir e aromë mëmësie,
- dihat (nga lodhja, ngjitja?),
- ka një pus të thellë në krye që zbret deri në mitër,
- i jehojnë lutje n'shpirt dhe i gurgullon heshtje n'fyt,
- është një krijesë që përshëndet duke u përlur,
- se flet.

Ajo thotë: “Sa lehtë më ke lindur, sa heshtur.” Dhe është ajo që e mbyll poezinë me: “Vijnë më pas.” Mua më vjen si Amësia. Por ajo që ma veçon këtë poezi, nuk është edhe aq kjo figurë. Në të vërtetë, ajo që më tërheq edhe më shumë, është ai raporti intim që poetja krijon midis vetes (dhe, si rrjedhim, lexuesit që i rri mbas supit) dhe krijesës. Është një raport dashurie, por shkon edhe më tej, është një raport pasioni. Sepse kur i afrohem krijesës dhe e shoh nga afër, vërej se ai kryeti në formë hinkë është i gjallë dhe se pluhuri dhe drita janë në lëvizje marramendëse. Ajo hinka e qetë në dukje, gati si një fotografi e galaktikës Rruga e Qumështit, nga afër është një vorbull. Ky është sekreti teknik i poezisë. Një vorbull që mua si lexuese më thith të tërën në qendrën e saj: në mitër. Gëzueshëm. Ajo rënia me ndjesinë e ngjitjes i ngjan efektit të tornados. Një vorbull ndjenjash festive që të thithin poshtë dhe të shtynë lart njëkohësisht. Kjo poezi është një rënie e lumtur, është një dorëzim i mbarsur.

Leximi i tretë (leximi i mendimit)

Poezia e mirë e shtyn lexuesin pashmangshëm në një lexim të tretë, leximin e mendimit. Poetët e talentuar mbjellin mendime dhe përjetime në ne. Leximi i tretë e ndihmon lexuesin të ndjekë fillin e mendimit të poetit dhe fillin e mendimit të vet.

Amësia është ajo ndjenjë e mrekullueshme që e përfshin gruan qysh në momentin kur në mitrën e saj nis e gurgullon heshtja e krijimit. Por kjo poezi nuk është vetëm kaq. Nuk është vetëm mëmësi. Nuk ka të bëjë vetëm me gruan e mbarsur dhe gruan nënë. Amësia është ndjenja që buron nga ama. Dhe ama është vezorja e gruas, por është edhe vendi ku nis një rrjedhë uji. Ama është edhe gurra, është edhe druri që mban çatinë. Ama është ndjenja që na mban në amë, në udhën e drejtë. Është ndjenja që na fisnikëron, na fton të kujdesemi për jetën në të gjitha format e saj, na i jep kuptim jetës. Dhe kjo pavarësisht në jemi burra a gra, në jemi prind a jo. Është një ndjesi që ia beh herë pas here tek të gjithë ne dhe na pastron prej ligësisë dhe fanatizmit. Hera-herësia beh një krijesë pluhuri e drite që na mëson të lëshohemi në vorbullën e purifikimit, e pastrimit, për të parë vlerën e vërtetë të jetës, për të parë amën.

Leximi i katërt (leximi i vetes)

Në leximin e katërt lexuesi e njeh mirë poezinë. Nëse ka mbërritur deri këtu, e do këtë poezi, e dashuron. Për temën, gjuhën poetike, për mjeshtërinë e realizimit, për fillin e mendimit, por sidomos sepse në leximin e katërt ka për ta ndier poezinë deri në fund, ka për t'ia ndier dehjen, magjinë, do të jetë a thua se e ka shkruar vetë.

Po dhimbjet, Entelë? Ato vijnë më pas.

“

Ama është edhe gurra, është edhe druri që mban çatinë. Ama është ndjenja që na mban në amë, në udhën e drejtë.

Leximi i poezisë “Hera-herës” të Mariklena Niços

GJERGJ FISHTA DHE FOLKLORI

Nga Tonin Çobani

Improvizimet e para

Fishta, fshat i vogël në Zadrimë, ndërmjet qyteteve Shkodër dhe Lezhë, është emër=vendi i parë i rëndësishëm që lidhet me Gjergj Fishtën. Aty lindi fëmija me emrin Zef (Zefi i vogël), që më vonë do të njihet me emrin e madh Gjergj Fishta. Zefi është fëmija e katërt në vatrën e Ndokës (babai) dhe Prendës (nëna), nga fshati Kotërr/ Zadrimë. Ai lindi pas dy vëllezërve (Leka dhe Simoni/ Çupi) dhe motrës (Lena). Të katër fëmijët lindën në një shtëpi të madhe prej 96 pjesëtarësh (Gj. Frani), diçka që sot është vështirë të përfytyrohet. Por kjo shtëpi e madhe u shpërbë në fund të shekullit XIX, pikërisht kur Gjergj Fishta ishte rreth të shtatëmbëdhjetave. U shpërbë më pas edhe vatra e Ndokajve: Simoni (ose Çupi) u vra (1899), Leka u nda kësaj bote në kapërcyell të dekadës së dytë dhe të tretë të shek. XX, duke lënë pesë djem dhe një vajzë. Ndërsa Lena ka jetuar më gjatë, rreth të 80-ve. Vdiq në vitin 1948, e pamartuar. Emërvendi i dytë i rëndësishëm është Troshani (shumë pranë fshatit Fishtë), ku ishte ngritur qysh në gjysmën e parë të shekullit XVIII Kuvendi i Françeskanëve, i pari kuvend françeskan në Zadrimë. Madje është edhe para Kuvendit të Arrës së Madhe dhe të Gjuhadolit në Shkodër. Ndoshta, është edhe para Kuvendit të Lezhës, sado që njihet një gojëdhënë që e dëshmon Kuvendin Françeskan të Kishës së Dom Lleshit si të bekuar prej vetë Shën Françeskut të Asizit. Në vitin 1871 famullitari i kishës së Troshanit mbulonte me shërbesa fetare edhe banorët e fshatit Fishtë, pra, pagëzon edhe Zefin e sapolindur në konakun e Ndokajve. Ai është një poet që do të ndikojë shumë në formimin kulturor të Zefit/ Gjergjit nëpër të gjitha fazat e zhvillimit të tij si poet e dramaturg, si eseist e publicist, si mësues dhe veprimtar për çështjen kombëtare: ai është At Leonardo de Martino, OFM... Por ne le t'i afrohem edhe më pranë vatrës familjare të Zefit të vogël. Të dy vëllezërit dhe motra, Lena, kanë qenë të njohur për talentin e tyre si poetë popullorë. Ata kanë dhuntinë e improvizimit të vargjeve të rimuara: në formë replikash në lojërat populllore, si Loja e Kapuçave (Çupi dhe Leka), në formë elegjish në raste mortesh (Lena), në formë urimesh e shpotitjesh në raste festash familjare e shkollore. Për vargjet e fundit shquhej veçanërisht Zefi i vogël, më vonë Gjergj Fishta i Madh. Aftësi të tilla për të improvizuar me lehtësi vargje të rimuara duhet të kenë pasur edhe prindërit e këtyre fëmijëve. Fishta thoshte për vëllezërit e vet: *Medet, po të kishin pasë fatin tim, do të kishin dalë kush e di sa herë ma të mirë se unë: do ma kishin kalue 'i qind herë (njëqind herë)...* Sa për Zefin e vogël dëshmohej prej Pashk Bardhit: fillimet letrare të Gjergj Fishtës janë vargjet e përsëndetjeve të tij me raste festash dhe përvjetorësh për bashkëstudentët dhe bashkëkolegët e vet, duke nisur nga viti 1886 kur Gjergj Fishta ishte rreth të 15-tave. “Shokët e tij të kuvendit shkriheshin gazit me vargjet që sajonte aty për aty”. (Arshi Pipa) Disa prej këtyre vargjeve kanë qenë ruajtur nga Pashk Bardhi. Disa edhe janë botuar. Diku përmendet edhe një titull libri me autor Fishtën kur ishte seminarist (Bejta të një xhakoni të ri). Por nuk njohim vargje prej tij, ashtu sikundër sot nuk

dihet se ku kanë përfunduar vargjet në dorëshkrim, që ruheshin prej Pashk Bardhit.

Botimet e hershme

Ndër miqtë dhe dashamirësit e Fishtës, që kanë mbetur vargjeve të botuara të Poetit të *Lahutës*, janë, së pari, dy poetë sllavë që njohu ndërsa studionte në Bosnjë-Hercegovinë: (1-ri) poeti françeskan boshnjak Grga Martić (1822-1905), të cilin Fishta e njohu personalisht (dhe i kushtoi një poezi në vitin 1886, serbokroatisht) dhe (i 2-ti) poeti kroat Silvije Strahimir Kranjčević (1865-1908), me të cilin poeti ynë kishte miqësi (edhe këtij i kushton një poezi italisht, më 1892). Ajo është ruajtur, pasi ka qenë botuar më 1933-1934 në vëllimin e veprave të plota të poetit kroat. Ndër shqiptarë përmenden: Lazër Mjeda (1901/11), Anton Xanoni (1908,1915), Faik Konica (1908), Luigj Gurakuqi (1909), Vinçenc Prennushi (1909), Pashk Bardhi (1920) etj. Gjergj Fishta futet kështu në letrat shqipe si një poet i lindur, që improvizon vargje të rimuara me lehtësi. Por vargjet e tij të improvizuara vijnë gjithnjë e më tepër të ngjeshura me ide dhe emocione të fuqishme universale. Vargje të tilla u botuan fillimisht te revista *Albania* e Faik Konicës: “Kangë malcorisht” (1900/4) “Kangë mirditnish” (1900/6), “Kangë malcorisht” (1900/9), “Kanga e Gjin Lekës” (1901/10), “Kanga e Ndoc Kolës” (1904/6), ndonjëra prej të cilave ka qenë klasifikuar si këngë folklorike, duke qenë se Fishta i kishte nënshkruar me pseudonimin “E popullit”. Me këtë pseudonim do të nënshkruhen edhe dy blenet e para të “Lahutës së Malcis” (1904/5, 1907).

A e ka mohuar Fishta autoktoninë e këngëve epike shqiptare

Fishta ka shkruar për folklorin duke nxitur mbledhjen dhe studimin e tij ndër kolegët françeskanë dhe jo vetëm. Sipas Benedikt Demës, ai ka shkruar edhe parathënien e vëllimit të parë të “Visarit Kombëtar, kangë popullorë gegnishte, rendue prej A. Vinçenc Prennushit” (Sarajevë, 1911). Ndonjë studiues tjetër i mëvonshëm, siç është Veis Sejko, në librin e tij “Mbi elementet e përbashkëta në epikën shqiptaro-arbëreshe dhe serbokroate” (2002), ka mbrojtur mendimin se autori i asaj parathënieje nuk është Fishta, por vetë Vinçenc Prennushi, prej të cilit citohet paragrafi që deklaron se në folklorin shqiptar nuk ka këngë epike, pasi *do rapsodija e legjenda si b.f. kanga e Mujos dhe Halilit, kanga e Halil Garriës, kanga e Kalasë së Shkodrës, etj, na duket se janë të përkthyme prej sllavishtes... të gjitha gjinden në literaturë të serbëve dhe kroatëve.* (f. 171). Madje, aludohet se ai paragraf është shtuar (dora vetë ose me porosi të tij) nga drejtori i atëhershëm i Institutit të Sarajevës (serbi Qiro Truheljka), albanolog që nuk dinte shqip. Por ai dinte veçse *bozaxhinjtë dhe halvaxhinjtë prunë epikën boshnjake në Shqipëri* (f. 175), prandaj këngët epike të Veriut të Shqipërisë nuk përfshihen në “Visarin Kombëtar” të Prennushit. Ato këngë u fshehën: Sejko beson *që po të bëhet një gjurmim i mirë në arkivat e Institutit të Sarajevës për kohën para vitit 1911, mund të gjenden dorëshkrimet e Prennushit mbi këngët*

epike malësore shqiptare... Në kapitullin “Dy renegatë të kombit shqiptar” (dhe ata janë Vinçenc Prennushi dhe Stavri Skendi), Sejko argumenton lajthitjen e tyre shkencore si vënie në shërbim të interesave të të huajve. Sidoqoftë, edhe nëse ajo parathënie është shkruar (ose jo) nga Fishta dhe ai paragraf është shtuar (ose jo) nga botuesi, një mendim i tillë për epikën e folklorit shqiptar të Veriut nuk është formulim i Fishtës. Ose ka qenë një konkluzion kalimtar, tepër i përkohshëm. Për këtë sjellim në vëmendje tre fakte. **I pari** lidhet me një recension të Fishtës në numrin e parë të revistës “Hylli i Dritës” (1913) për librin e Prennushit. Fishta vlerëson rëndësinë historike të folklorit shqiptar (*Kangët popullorë janë një dokument rëndësie të madhe për historinë*) dhe bën vërejtje për shënimet (*oroet*) e autorit, të cilat po të ishin *pak gja ma të shpeshta e ma të plota, nuk kishte lanë kurrigjë mangut për me qenë vlerësuar (njehë), një ndër ma të vlershmet vepra të literaturës kombëtare* (Gjergj Fishta, “Vepra letrare 9”, f. 24). **Fakti i dytë** është një vlerësim (në të njëjtin recension) për mjeshtërinë e të shkruarit të parathënies, të cilën Fishta e cilëson si ligjëratë të autorit (Vinçenc Prennushi): *Para kangëve dhe valleve popullorë, - shkruan Fishta në revistën e tij, - autori ka vu një ligjëratë...* (Po aty, f. 24). Pra, jo autori i recensionit (Fishta) e ka shkruar atë ligjëratë (parathënie). Nuk e ka shkruar as një grup fetërish, si përpiket të justifikojë mungesën e autorësisë së parathënies, Alfred Çapaliku në monografinë e vet kushtuar Viçenc Prennushit (f. 84). **Fakti i tretë** është letra që Fishta ia dërgon albanologut austriak, Nobert Joklit, së bashku me këngët: *Martesa e Mujit, Martesa e Halilit, Gjergj Elez Alia dhe Muji e Behuri*. Fishta i kërkon një vlerësim (“nji gjygj”) për këngët dhe e pyet: *A mos gjindemi para ciklit rapsodijash mbetë prej ndonji poemit të madh të vjetër?* Kjo pyetje Fishtës i ka lindur pasi ka mësuar se një malësor (Malësia e Madhe) ka pohuar se di rreth 63 *rapsodija mbi Mujin e Halilin, e thotë se të gjitha kanë një lidhni ndërmjet vedit* (Fishta, “Estetikë dhe kritikë, f.85). Autori i “Lahutës...” as nuk e vë në kandar mendimin se ato këngë mund të jenë të përkthyer ose jo nga serbo-kroatishtja. As nuk kërkon mbështetje kundër *tezës boshnjake* që qarkullonte asokohe në shkrimet e studiuesve sllavë dhe jo vetëm. Po, ai shton se rapsodi shqiptar sot gjendet nën Jugosllavi. Konkluzioni (tashmë i qëndrueshëm) për problemin e ngritur është i thjeshtë. Ose Fishta nuk ka menduar asnjëherë se në folklorin shqiptar mungojnë këngët epike, pra edhe parathënia në fjalë (ose vetëm ai paragraf, që konteston Sejko) nuk është shkruar ndonjëherë prej Poetit tonë. Ose, së paku, dy vjet mbasi është botuar ajo parathënie, mendimi i shprehur në atë paragraf nuk qëndron më. Aq më pak, qëndron ai mendim në vitin 1926 kur Fishta i shkruan Joklit. Lëre më, të themi, në vitin 1937, kur botohen “Visaret e Kombit 2, kangë kreshnikësh dhe legjenda” të françeskanëve të nxitur prej Fishtës, Benardin Palaj dhe Donat Kurti. Fishta, në një CV të vetën shkruar në italisht e përfshin edhe veten në studimin dhe mbledhjen e folklorit kombëtar shqiptar (Benedikt Dema).



Doli nga shtypi “Ikona e Skënderbeut në jetën kulturore dhe artistike të Venedikut (Nga historia te miti: shekujt XV-XVIII)”, një vepër e re e profesoreshës Lucia Nadin, përmbledhje me studime të shkruara kryesisht vitet e fundit, botuar në kuadrin e vitit jubilar të sapopërfunduar të 550-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, përkthyer në gjuhën e shqipe dhe përgatitur për botim nga prof. as. dr. Evalda Manovi Paci, botuar nga Akademia e Studimeve Albanologjike

“SKËNDERBEU” I LUCIA NADINIT EVALDA PACI: SI U SHKRUA VEPRA PËR KULTURËN SHQIPTARE NË VENEDIK

Si përkthyes dhe përgatitëse e botimit të profesoreshës Lucia Nadin mbi figurën e Skënderbeut, të titulluar “Figura e Skënderbeut në jetën kulturore dhe artistike të Venedikut (nga historia te miti: shekujt XV-XVIII)”, Tiranë, 2018, si u gjendët kur për herë të parë ju ra në dorë varianti i sjellë fillimisht prej saj? Çfarë është ky botim?

Kur kam pasur fillimisht në dorë materialin e përzgjedhur për botim nga autorja, kam vërejtur menjëherë që bëhej fjalë për një përmbledhje sprovash të cilat ajo prej vitesh i kishte përpiluar dhe arsyetuar në një kuadër sa historiografik, aq edhe të dhënash të tjera që lidheshin me disiplina të afërta me historinë, kryesisht me atë të Skënderbeut. Autorja ka hulumtuar gjatë rreth kësaj figure, por duke u përpjekur të përqendrohej kryesisht në reflektimin dhe jetëgjatësinë e saj në lokalitete dhe kisha të zonës së Veneto-Padova-s, duke iu referuar indiceve që edhe sot e kësaj dite mund të konsultohen nga afër në objekte kulti të cilat ajo i njeh dhe i sjell më pranë, dhe nëpërmjet trajtesave të cilat i ka arsyetuar dhe shtjelluar në kapitujt e parë të veprës së saj. Fatmirësisht, edhe pasqyrimi në foto e detaje fotografike që ilustrojnë më mirë njohjen nga afër të elementeve arkitektonike që përmbajnë motive që lidhen me ngjarje të luftërave të

kohës së Skënderbeut, ndihmon të krijohet një ide më e qartë mbi sa parashtron autorja në punimin e saj. Në të vërtetë, për idenë në fjalë, por edhe për një pjesë të materialeve që do të botoheshin, unë isha e informuar që kur me autoren u gjenda në një konferencë shkencore në Shkodër, që i kushtohej figurës së Zojës së Këshillit të Mirë e që u celebrua në një kontekst që natyrshëm të lidhet edhe me Skënderbeun dhe ndikimin e episodeve të historisë së tij edhe në Veri të Shqipërisë.

Përveçse ka qenë e përqendruar në trajtimin e jehonës së figurës së Skënderbeut në Venedik dhe rrethina që nga shekulli kur ai ishte gjallë e më tej, a ruan edhe kjo vepër e profesoreshës Nadin lidhjet me botime të mëparshme të saj e që lidhen me botën shqiptare?

Pa dyshim që kjo lidhje kryesisht tematike mund të konstatohet fare qartë në kapitujt të mëtejme të veprës në fjalë dhe në krerë në të cilët analizohen figura konkrete klerikësh që kanë mbetur në historinë e kishës së kohës për arsye të caktuara e për të cilat autorja siguron edhe prejardhjen shqiptare. Ky fakt ka bërë që edhe unë në proces të përgatitjes së veprës për botim t’i rikthehem një botimi të mëparshëm të saj, që u botua nga Shtëpia Botuese Bulzoni (Romë, 2008) dhe që lidhej me migrimet shqiptare kryesisht në drejtim të Venedikut. Referimi ndaj kësaj vepre të mëparshme ishte më se i domosdoshëm në jo pak paragrafë të veprës dhe një fakt i tillë është pasqyruar edhe në shënimet me të cilat i kam pajisur dhe shpjeguar ato. Në të vërtetë, trajtimi i hollësishëm i të dhënave arkivore dhe biografike që ka sjellë autorja në këtë pjesë të veprës i shërben rindërtimit të një kuadri a konteksti më të gjerë historik që shpie në reflektime mbi marrëdhëniet reale të kohës mes Venedikut dhe kishës së Romës, linjë kjo që është ndjekur nga autorja përmes arsyetimesh dhe konkludimesh të matura.

A është pasqyruar historia e artit venecian edhe në këtë vepër? Tituj paragrafësh të saj bëjnë të mendosh se pikërisht një gjë e tillë ishte qëllim i vetë autores.


Po, patjetër që kjo lamije studimore ka qenë dhe mbetet në interesat studimore të profesoreshës Nadin, e interesuar përherë të gjejë edhe në këto objekte e monumente fije lidhëse me historinë e institucioneve të caktuara dhe pse jo, edhe me vendin tonë në këtë rast. Konsultimi i vazhdueshëm dhe konsekuent i burimeve arkivore ka sjellë edhe më tepër arsyetime dhe deduktime nga ana e saj, duke shprehur njëkohësisht edhe dëshirën e mirë që edhe nga studiues pasardhës të ndiqen të njëjtat pista kërkimi e hulumtimi. Ajo ka analizuar hollësisht vepra arti, vepra të artistëve më në



zë të kohës, që kanë pasuruar edhe motive biblike në krijimtarinë e tyre. Rasti i Paolo Caliari-t (Il Veronese) dhe i personazheve biblike nga Besëlidhja e Vjetër që ai bën objekt vëmendjeje, i kanë shërbyer autores të rindërtojë edhe arsyetime që lidhen me kishën në Shqipëri dhe fatin e martirëve të krishterimit. Kapitulli III (f. 123-141), që lidhet me shekullin XVI, mbetet në të vërtetë një prej krerëve më interesantë të kësaj vepre, që lexohet dhe rilexohet me ëndje dhe interes nga kushdo që ka interesa studimore në disa disiplina, duke qenë se qasja e autores është mirëfilli ndërdisiplinore dhe arrin të ketë impakt pozitiv te lexuesit dhe studiuesit e punimeve të saj. Duhet theksuar edhe këtë herë që çdo linjë që shtrohet me qetësi e maturi nga autorja që në krye të trajtesave të saj, merr shtjellim hap pas hapi derisa, më në fund, kihet e qartë që ajo ka parashikuar që faktet e marra në shqyrtim i shërbejnë një ideje a një përfundimi që edhe hulumtues të tjerë mund ta marrin në konsideratë ose ta shpien më tej. Në këtë vepër që sapo pa dritën e botimit, janë përfshirë e sjellë në një trajtë më të zgjeruar, ose ndonjëherë më të përmbledhur, linja e trajtesa që në formë artikujsh kanë parë dritën e botimit në periodikë shkencorë apo akte botimi që mbartin vulën e një serioziteti të mirëfillt shkencor. Fakti i përfshirjes në një botim tematik ka shtyrë autoren edhe t’i rishohë ato në kuadrin e një vepre unike, gjë që e ka reflektuar dhe në proces të bashkëpunimit tonë të frytshëm në periudhën e përkthimit dhe përgatitjes për botim të saj.

A ka qenë Rrethimi i Shkodrës objekt interesi edhe për këtë botim më të fundit të profesoreshës Lucia Nadin?

Po, ky argument ka qenë objekt interesi, dhe jo vetëm duke pasur referencë një autor me emër siç ishte Marin Barleti e që mbetet një burim referencial gjithmonë për t’u konsideruar në traditën e historiografisë skënderbeiane. *Rrethimi i Shkodrës* është sjellë pikërisht në këtë libër (kapitulli I i veprës, përkatësisht f. 55 v.) dhe përmes transmetimit të të dhënave që kanë qarkulluar nëpërmjet një forme tjetër narrative, të ashtuquajturave *kantare*, nëse kemi parasysh emërtimin *ad hoc* të autores dhe që nënkuptojnë forma gojore rrëfimtarije, mjaft me interes si në pikëpamje të gjinisë që përfaqësojnë, ashtu dhe nëse kemi parasysh që pasurojnë kuadrin e konceptimit të një ngjarjeje që lidhet ngushtë me Shkodrën, por edhe me Venedikun si shtet që pati rolin e vet edhe në drejtim të historisë së kështjellës që u rrethua gjatë dhe më në fund, ra pre e pretendimeve osmane në shekullin XV. Por nuk mungon, gjithsesi, referimi ndaj Barletit dhe



të dhënave që ai sjell mbi këtë ngjarje që ka shënuar njëkohësisht historinë e dy vendeve, të cilat duket se historia i ka bashkuar prej shekujsh.


A mund të veçoni një pjesë të veprës që e mendoni më interesante në pikëpamjen tuaj?

Unë do të thosha që e tërë përmbledhja e sjellë nga autorja është një dëshmi e një përkushtimi dhe e një pune kërkimore që ka kërkuar kohë të konsiderueshme dhe një durim jo të zakonshëm, nëse kemi parasysh faktin që ajo ka gjurmuar arkiva e biblioteka në të cilat mendonte se do të gjente të dhëna mbi personazhe dhe periudha që lidhen me historinë e Shqipërisë dhe marrëdhëniet e saj me Venedikun, argument ky që asaj i ka interesuar me vite e duke pasur shtysë edhe një ndjenjë të singertë afeksioni për vendin tonë, në këtë rast edhe për figurën e Gjergj Kastriotit, Skënderbeut. Por do të veçoja, ndër të tjera, edhe një kapitull që ka për objekt trajtëse armaturën e Skënderbeut e që, në të vërtetë, përmban një nomenklaturë të tërë mbi armët e kohës dhe kontekstin historik që lidhet me të. Kjo trajtesë që përbën dhe kreun përmbyllës të kësaj vepre (f. 227 v.), në të vërtetë, është një parashtrim kërkimesh të cilat besoj se do të vazhdojnë më tej nga studiuesja Nadin, e cila gjykon se konteksti venecian dhe arkivat përkatëse akoma mund të ofrojnë të dhëna me vlerë në lidhje me figurën e Gjergj Kastriotit dhe periudhën historike në të cilën ai jetoi.

Sa frytdhënëse konsiderohet prej jush një punë e tillë që, siç shpreheni edhe ju vetë, është pasqyruar në përkthimin nga origjinali të materialeve studimore dhe përgatitjes për botim të tyre në kuadrin e një vëllimi ngushtësisht tematik?

Kjo punë që, sigurisht, ka kërkuar një investim të konsiderueshëm intelektual dhe mendor, është kurorëzuar në një kornizë të denjë institucionale, duke mbartur stemën e botimeve tematike të Akademisë së Studimeve Albanologjike, pikërisht botimeve që janë menduar të realizohen në kuadrin e celebrimit të 550-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Ka qenë një punë frytdhënëse që ka pasur edhe përmasën e bashkëpunimit hap pas hapi me autoren e veprës, e cila nuk është kursyer asnjëherë për të sqaruar elemente të cilat mbartnin qartë gjurmë të një konteksti mjaft specifik që ka të bëjë si me largesën në kohë të ngjarjeve të marra në shqyrtim, ashtu edhe me vetë veçantinë e tematikës së përzgjedhur. Shqipërimi dhe përgatitja për botim kanë kërkuar pa diskutim edhe kërkime në disa fusha të terminologjisë, kryesisht në atë të historisë së arkitekturës kishtarë, por edhe historisë së artit e të teatrit italian. Venediku, me historinë e tij dhe rënien e pashmangshme në shekujt pasues, është pasqyruar me tërë shkëlqimin e mundshëm nga autorja, por nuk është lënë jashtë vëmendjes dhe lidhja e pamohueshme me një vend të afërt si ai yni. Besoj plotësisht që kjo vepër ka ardhur në selinë e duhur institucionale dhe në kohën e duhur, duke qenë se pa dritën e botimit në një vit promocional që lidhje ngushtësisht me figurën e heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastriotit. Siç dhe mund ta thonë e pohojnë njëzëri shumë kolegë të tjerë të së njëjtës fushë studimore, libri i fundit i studiueses Lucia Nadin është një vlerë më vete, por shumë e veçantë që pasuron panoramën e botimeve albanologjike.

Intervistoi: V. Murati



1474: Epopeja e madhe e Shkodrës – shtysë për përvetësimin nga ana e Venedikut e Figurës së Skënderbeut

Nga Lucia Nadin

Shkodra, aleate fort besnike e Venedikut

Siç dihet, qe Marin Barleti që bëri të mundur me veprat e tij transmetimin e ngjarjeve që tronditën Shqipërinë e shekullit XV: atij i detyrohet rindërtimi i një imazhi mbi At dheun e vet si tokë e heroizmit ekzemplar. Duke u nisur nga eventet historike që e kishin bërë protagonist, Barleti u jep historive të tij (si asaj të Shkodrës, si asaj të jetës dhe bëmave të Skënderbeut) një gjurmë të fortë humanistike që, për t'u kuptuar më mirë, duhet të përfshihet në kontekstin venecian në të cilin ai operon si shkrimtar. Pse e gjithë kjo? Sepse vullneti i tij për t'i ngritur një monument historisë së vendit të vet, në fund të fundit, i shërbente interesit të Venedikut në rindërtimin e një miti të Shqipërisë si pjesë e Shtetit detar që ajo përfaqësonte.

Le të reflektojmë mbi datat.

Barleti shkruan në vitet e para të shekullit XVI. Në vitin 1504 botohet *Rrethimi i Shkodrës*, ndërsa Jeta dhe bëmata e Skënderbeut në vitin 1510. Në atë kohë një pjesë e madhe e Shqipërisë nuk ishte më nën protektoratin venecian, ngjarjet që e kishin tronditur i përkisnin tashmë së shkuarës, ishin sedimentuar në kujtesën dhe katalogimet e ngjarjeve më të jashtëzakonshme të historisë dhe ishin gati të ripërpunoheshin më tej në konturet e celebrimit të faqeve ekzemplare të saj.

Shkodra kishte qenë mburoja e Venedikut, për të mos thënë stolia me të cilën ky i fundit zbukurohej, gjithnjë një aleate fort besnike; ndër të tjera, Shkodra nuk kishte rënë në duar të turqve, atyre u ishte dorëzuar kjo e fundit për interesat veneciane të tregtisë dhe kështu vetë Senati vendosi që Shkodra duhet të shpërblehej, si në pikëpamje të pritjes dhe integritetit të qytetarëve të mbijetuar të saj, ashtu edhe në kompensimin e një imazhi zyrtar që do ta përfshinte tërësisht në horizontin mitik venecian.

Epopeja e Shkodrës (e vitit 1474) do të shihet më tej që kishte lindur vetëm gjashtë vjet pas vdekjes së Skënderbeut (shkurt 1468). Edhe për Venedikun, të lënë vetëm nga Europa në luftën kundër turqve, bëhej fjalë për një ndeshje fort të rëndësishme që do të luhej rreth mureve të Shkodrës së tij, tashmë trashëgimtare e periudhës së madhe të Skënderbeut. Ajo ishte bërë trashëgimtare edhe e titullit që i ishte atribuar Skënderbeut si “mbrojtës i krishterimit”; dëshmitari i pishtarit të mbrojtjes kishte kaluar tashmë në Shkodër dhe një sërë variantesh atributive ia zgjeronin rolin: Shkodra, mburojë e çdo të krishteri, ashtu si Skënderbeu; Shkodra mburojë në kraharorin e Mbretëreshës (Venedikut), në një ripërmbledhje interesash krejtësisht veneciane.

Shkruhej kështu gjatë vitit 1474 një faqe themelore historie veneciane, shqiptare, adriatike e duhej të lartësohej kjo gjë nga politika e mëtejme veneciane gjithnjë më në ngërç prej morsës turke në tokat në Jug të Europës.

Rrethimi i Shkodrës do të dilte nga shtypi në vitin 1504, pothuaj tridhjetë vjet pas ngjarjes së



madhe, kur Venediku kishte humbur si Shkodrën, ashtu edhe Durrësin. Dilte kështu pas traktativave të paqes në vitin 1503 që i jepnin fund luftës së dhjetëra vjetëve dhe që do të duhej t'i jepnin frymë ekonomisë. Inkursioni i turqve kishte arritur deri në Friuli në vitin 1499, pothuaj në Venedik.

Viti 1503 është viti i mbylljes së një faze historike të shënuar prej luftërash e bëhet pikë nisjeje për të rihedhur mesazhe paqeje dhe njëkohësisht ripërtëritjeje, ndërmjet luftërave të kaluara, të momenteve më të lavdishme, gjithsesi, për palën shqiptaro-veneciane. Ripropozohet kështoj një epopë e lindur në dhjetëvjeçarët e mëparshëm, ajo që e kishte parë Shqipërinë si “mburojë” të Venedikut dhe mburojë të krishterimit perëndimor.

Rezistenca e Shkodrës në dy rrethimet e egra që kishte pësuar, Shkodra që kishte qenë “trashëgimtare” e pesë pesëvjeçarëve të një rezistence të pashembullt të Skënderbeut ndaj sulmeve osmane, përbën një pikë nisjeje të detyrueshme dhe funksionale për rindërtimin e mëtejme në vitin 1510 të figurës së Skënderbeut si aleat besnik i Venedikut, që do të duhej të mbetej i tillë në kujtesën historike të Serenissima-s.

Sa ka qenë Marin Barleti artist në rindërtimin e asaj Figure, sa ka qenë funksionale ajo për politikën veneciane, sa ka qenë Barleti një “krijesë” veneciane, kjo është tezë që mbështetet prej nesh mbi bazën e të dhënave arkivore të zbuluara e prej studimit të relacioneve që e lidhën atë me ambientin politik e kulturor në Venedik. Të vërehet zinxhiri silogjistik përkatës: Skënderbeu kishte qenë mburojë a barrierë për përparimin e turqve; pas vdekjes së tij është Shkodra besnike që bëhet mburojë dhe barrierë për atë avancim dhe ngjarjet e vitit 1474 do t'i shohin të impenjuar në një lidhje të ngushtë venecianët dhe shkodranët; vetë Venediku, nëpërmes komandantëve të vet, loredanëve dhe mocenigove, është në rresht të parë në Shqipëri. Kështu dhe Skënderbeu përmes ngjarjeve të Shkodrës fiton të gjitha ngjyrimet veneciane dhe bëhet edhe ai vetë aleat besnik i Venedikut. Pa ndërmjetësimin e ngjarjeve heroike të Shkodrës (dhe Drivastit) nuk do të mund të konsolidohej Ikona e të madhit Shqiptar, aleatit besnik, që do të konsiderohej në shekujt e mëvonshëm nga pala veneciane. Këtu më tej do të paraqitet një letërsi popullore mjaft e pasur dhe interesante e zhvilluar në Venedik, ndërkohë që zhvilloheshin sulmet turke ndaj fortesave të Shkodrës dhe Drivastit. Ajo përfshin ngjarjet e shekullit XV në viset shqiptare në letërsinë europiane dhe më në veçanti, në përbërje të traditës së kantarëve. Bëhej fjalë për një gjini epike popullore që gjatë mesjetës së hershme rrëfente kohën e epopesë së madhe të Karlit të Madh dhe të kalorësve të tij. Kështu, në katërqindën e vonë veneciane rrafshina poshtë Shkodrës i mbivendosej asaj të Roncisvalle-s dhe shkodranët e rrethuar u lartësuan për bukurinë e tyre, me një armaturë fine ashtu si dhe kalorësit e Karlit të Madh.

GABRIEL GARCÍA MÁRQUEZ TAKON ERNEST HEMINGWAY-n

Nga G. G. Márquez

Enjoha menjëherë, ndërsa kalonte me gruan e tij, Mary Welsh, në Bulevardin St. Michel në Paris, një ditë pranvere me shi në vitin 1957. Ai po ecte në krahun tjetër të rrugës në drejtim të Kopshteve të Luksemburgut, dhe kishte veshur një palë pantallona kaubojsi të grisura, një këmbishë me kuadrate dhe një kapele beizbolli. E vetmja gjë që nuk dukej se i përkiste, ishin një palë syze me kornizë metalike të vogël e të rrumbullakët që i jepnin një hije prej gjyshi, diçka e parakohshme për të. Sapo kishte mbushur 59 vjeç dhe ishte trupmadh e binte goxha në sy, por nuk të jepte përshtypjen e forcës brutale fizike të cilën ai padyshim e donte, pasi i jetë i kishte të ngushta dhe këmbët i dukeshin paksa të holla mbi këpucët e trasha të sharrëxhiut. Ai dukej kaq i gjallë midis tezgave të librave të përdorur dhe vërshimit të të rinjve nga universiteti Sorbonne, saqë ishte e pamundur të përfytyroje se i kishin mbetur vetëm katër vite për të jetuar.

Për një fraksion sekonde, ashtu siç më ndodhte gjithmonë, u gjenda midis dy pozitave konkurruese.

Nuk dija a t'i kërkoja një intervistë, apo të kapërceja bulevardin e t'i shprehja admirimin tim, pa u rezervuar. Por cilëndo të zgjidhja, përballesha me të njëjtën vështirësi. Në atë kohë, flisja po atë anglishte bazike që flas tani, dhe nuk isha aq i sigurt për spanjishten e tij prej toreadori. Ndaj, nuk bëra asnjërin prej këtyre që mund ta kishte prishur atë moment, por vendosa duart në formë hinke përpara gojës dhe ashtu si Tarzani në xhungël, thërrita nga krahun tjetër i trotuarit: "Maaaaeestrol!" Ernest Hemingway e kuptoi se në atë turmë studentësh nuk mund të kishte mjeshtër tjetër përveç tij, ndaj u kthye, ngriti dorën dhe bërtiti në gjuhën kastiliane, me një zë fëmijëror, "Adiooos, amigo!" Kjo ishte hera e vetme që e pashë.

Në atë kohë isha një gazetar 28-vjeçar me një roman të botuar dhe një çmim letrar të fituar në Kolumbi, por në Paris gjendesha pa ndonjë drejtim. Mjeshtërit e mi ishin dy romancierë nga Amerika e Veriut, që dukej se nuk kishin as edhe një gjë të përbashkët. Kisha lexuar gjithçka çfarë kishin botuar deri atëherë, por jo si lexim plotësues – krejt e kundërta, si dy forma

të dallueshme dhe përjashtuese të njëra-tjetrës, për konceptimin e letërsisë. Njëri prej tyre ishte William Faulkner, të cilin nuk e kisha parë asnjëherë dhe mund ta përfytyroja vetëm si një fermer me mëngë të përveshura, duke kruar krahun, pranë dy qenve të tij të vegjël të bardhë, si në foton e mirënjohur që i është bërë nga Cartier-Bresson. Tjetri ishte burri jetëshkurtër që sapo më kishte përshëndetur nga ana tjetër e rrugës, duke më lënë përshtypjen se diçka kishte ndodhur në jetën time, gjatë gjithë kohës.

Nuk e di se kush e ka thënë që romancierët lexojnë romanet e të tjerëve, vetëm për të kuptuar se si janë shkruar. Unë besoj se kjo është e vërtetë. Ne nuk kënaqemi me sekretet e zbuluara mbi faqe: e rrotullojmë librin sa nga njëra anë në tjetrën, për të zbuluar gjurmët. Në njëfarë mënyre që është e pamundur të shpjegohet, ne e zbërthejmë librin në pjesët e tij thelbësore, e pasi i kemi kuptuar misteret e mekanizmit të tij unik, i bashkojmë sërish. Kjo përpjekje është dekurajuese kur bëhet fjalë për librat e Faulkner-it, pasi nuk duket sikur ka një sistem të strukturuar shkrimi, por ecën verbazi përmes universit të tij bibliotekës, si një kope dhish që lëvizin të lira brenda një dyqani plot me kristale. Kur çmonton një faqe të shkruar nga ai, të duket sikur ke përpara një teprice sustash dhe vidhash, të cilat është e pamundur t'i rivendosësh aty ku ishin. Ndërsa Hemingway, ndryshe nga ai, me më pak frymëzim, pasion e çmenduri, por me një thjeshtësi të jashtëzakonshme, i lë vidhat plotësisht të dukshme, ashtu siç janë në një vagon mallrash. Ndoshta për këtë arsye Faulkner është një shkrimtar që lidhet shumë me anën time shpirtërore, por Hemingway është ai që ka pasur më shumë ndikim te teknika ime – jo thjesht përmes librave, por përmes njohurisë së tij të mahnitshme për sa i përket aspektit të mjeshtërisë në shkencën e të shkruarit. Gjatë intervistës së tij me George Plimpton-in në *The Paris Review*, (Hemingway) tregoi se, përkundër nocionit romantik, mirëqenia ekonomike dhe shëndeti i mirë, janë gjithmonë të favorshme për shkrimin; se një nga vështirësitë kryesore është vendosja mirë e fjalëve; se kur shkrimi bëhet i mundimshëm, është mirë të rilexosh librat e tu, në mënyrë që të kujtohesh se i tillë ka qenë gjithmonë; se mund të shkruash kudo për sa kohë që nuk ke vizitorë dhe telefon; dhe se nuk është e vërtetë se gazetaria është fundi i një shkrimtari, siç

“

Ernest Hemingway e kuptoi se në atë turmë studentësh nuk mund të kishte mjeshtër tjetër përveç tij, ndaj u kthye, ngriti dorën dhe bërtiti në gjuhën kastiliane, me një zë fëmijëror, "Adiooos, amigo!" Kjo ishte hera e vetme që e pashë.



thuhet shpesh, por e kundërta, për sa kohë që heq dorë mjaftueshëm shpejt. “Sapo shkrimi të jetë bërë mëkati kryesor dhe kënaqësia më e madhe”, tha ai, “vetëm vdekja mund t’i japë fund”. Në fund, mësimi i tij ishte zbulimi se çdo ditë pune duhet ndërprerë vetëm kur e di se ku duhet ta nisësh ditën tjetër. Nuk mendoj se është dhënë ndonjëherë këshillë më e vlefshme për shkrimin. Është, as më shumë e as më pak, ilaçi i vetëm për frikën më të tmerrshme të shkrimtarëve: agonia e mëngjesit kur përballesh me faqen bosh.

E gjithë vepra e Hemingway-t tregon se shpirti i tij ishte i talentuar, por jetëshkurtër. Dhe kjo është e kuptueshme. Një tension i brendshëm si i tiji, i nënshtruar ndaj një dominimi kaq të rreptë të teknikës, nuk mund të mbahet brenda hapësirave të paana dhe të rrezikshme të një romani. Kjo ishte vetë natyra e tij dhe gabimi ishte se u përpoq të tejkalonte kufijtë e tij të jashtëzakonshëm. Dhe kjo është arsyeja pse çdo gjë e tepërt është më e dukshme tek ai, krahasuar me shkrimtarë të tjerë. Romanet i ka si tregime të shkurtra që janë të shpërpjesëtuara, që përfshijnë më shumë se ç’duhet. Në kontrast, gjëja më e mirë e tregimeve të tij, është se të krijojnë përshtypjen sikur u mungon diçka, dhe kjo është pikërisht ajo që u jep misterin dhe bukurinë. Jorge Luis Borges, i cili është një nga shkrimtarët më të mëdhenj të kohës sonë, ka të njëjtët kufij, por ka pasur mençurinë që të mos përpiket t’i tejkalojë.

Vepra e Hemingway-t është e mbushur me gjetje të thjeshta dhe mbresëlënëse, të cilat zbulojnë pikën në të cilën ai përsoste përkufizimin e tij për krijimin letrar: se, ashtu si një ajsberg, qëndron i palëkundur vetëm nëse poshtë ka një bazament prej shtatë të tetat e vëllimit të tij.

Kjo vetëdije e teknikës është padyshim arsyeja pse Hemingway nuk do të arrijë lavdi me romanet e tij, por me tregimet e shkurtra që janë më të organizuara. Duke folur për “Për kë bien këmbanat”, ai tregoi se nuk kishte ndonjë plan të paramenduar për ndërtimin e librit, por e shpiku çdo ditë që kalonte. Nuk kishte përse ta tregonte këtë: kjo duket. Megjithatë, tregimet e tij të shkurtra të shkëlqyera, të cilat i ka shkruar njëkohësisht, janë të pakundërshtueshme. Si ato tre që

shkroi një pasdite maji në një pension në Madrid, kur një stuhi dëbore shkaktoi anulimin e një ndeshjeje me dema, gjatë festës së San Isidro-s. Këto tre tregime, sikundër ai i rrëfeu vetë George Plimpton-it, ishin “Vrasësit”, “Dhjetë indianët” dhe “E sotmja është e premte”, dhe të tre janë mjeshtërore. Sidoqoftë, për mendimin tim, tregimi në të cilin aftësitë e tij janë më të ngjeshura, është edhe më një nga më të shkurtrit që ka shkruar, “Macja në shi”.

Megjithatë, edhe pse duket si një ironi e fatit të tij, për mua, vepra e tij më magjepsëse dhe njerëzore është ajo që ka pasur më pak sukses: “Përgjatë lumit dhe nëpër pemë”. Siç e ka zbuluar vetë, ajo nisi si një tregim i shkurtër, dhe ndryshoi drejtim për nga xhungla e rizofove të romanit. Është e vështirë të kuptosh kaq shumë plasaritje në strukturë dhe kaq shumë gabime të rregullave letrare të një teknikien kaq i mençur – dhe dialogë kaq artificialë, madje të sforcuar, të një nga artarët më brilantë të historinë e letrave. Kur libri u botua në vitin 1950, pati kritika të ashpra, por të pabaza. Hemingway u ndie i lënduar aty ku i dhembte më shumë, dhe e mbrojti veten nga Havana, duke dërguar një telegram të vrazhdë që dukej i padenjë për një autor të nivelit të tij. Jo vetëm ishte romani i tij më i mirë, por ishte edhe më personal, pasi e kishte shkruar në fillimin e një vjeshte që nuk dihej, me një nostalgji për vitet e pakthyeshme që tashmë i kishte jetuar, dhe një parandjenjë prekëse për ata pak vite jetë që i kishin mbetur. Në asnjërin prej librave të tij nuk la shumë nga vetja, e as nuk gjeti, me gjithë bukurinë dhe butësinë, një mënyrë për t’i dhënë formë ndjenjës thelbësore të veprës dhe jetës së tij: kotësisë së fitores. Vdekja e protagonistit të tij, në dukje kaq paqësore dhe natyrale, ishte një parashikim i maskuar i vetëvrasjes së tij.


Kur jeton për shumë kohë me veprën e një shkrimtari, me kaq intensitet dhe dashuri, e ke të pamundur të dallosh trillimin nga realiteti. Kam kaluar plot orë dhe ditë duke lexuar brenda asaj kafeneje në Place St. Michel, të cilën ai e quante të mirë për të shkruar, sepse dukej e këndshme, e ngrohtë, e pastër dhe miqësore, dhe kam shpresuar gjithnjë ta gjej sërish atë vajzën që ai e pa të hynte në

një ditë të stuhishme, të ftohtë e me erë që frynte fort, një vajzë e cila ishte shumë e bukur dhe e re, me flokët prerë në mënyrë diagonale përgjatë fytyrës, si krahët e një korbi. “Ti dhe Parisi më përkisni mua”, shkroi ai për të, me atë fuqinë e pashtershme të përvetësimit që e shkruara e tij kishte. Çdo gjë që ai përshkruan, çdo moment, i përket atij përgjithmonë. Nuk mund të kaloj në No. 12 Rue de l’Odeon në Paris, pa e parë në bisedë e sipër me Sylvia Beach-in, në një librari e cila tani nuk është më e njëjta, duke shtyrë kohën deri në orën gjashtë të mbrëmjes, kur James Joyce mund të rastiste të vinte aty. Në prerinë e Kenya-s, vetëm duke i parë një herë, ai u bë pronari i buajve dhe luanëve të tij, si dhe i sekreteve më intime të gjuetisë. Ai u bë pronari i toreadorëve dhe boksierëve, i artistëve dhe kriminelëve, të cilët ekzistuan vetëm për një çast, kur u bënë të tijtë. Italia, Spanja, Kuba, gjysma e botës është e mbushur me vende të cilët ai i përvetësoi thjesht duke i përmendur. Në Cojimar, një fshat i vogël pranë Havanës, ku peshkatarët e vetmuar të librit “Plaku dhe deti” jetuan, ndodhet një pllakë përkujtimore për aktet e tij heroike, bashkë me një bust të praruar të Hemingway-t. Në Finca de la Vigia, strehën e tij kubane, ku jetoi deri pak përpara vdekjes, shtëpia qëndron e padëmtuar midis pemëve hijegjera, me koleksionin e tij të ndryshëm të librave, trofetë e gjuetisë, vendin ku shkruante, këpucët e stërmëdha, xhinglat e panumërta të jetës nga e gjithë bota, të cilat ishin të tijat derisa vdiq, e që vazhdojnë të jetojnë edhe pa të përmes shpirtit që u dha, thjesht prej magjisë që ai i zotëroi.

Disa vite më parë, hipa në makinën e Fidel Castro-s, i cili është një lexues i palodhur i letërsisë, dhe në sedilje më zuri syri një libër të vogël, të veshur me një lëkurë të kuqe. “Është mjeshtri im, Hemingway”, më tha Fidel Castro. Dhe vërtet, Hemingway vazhdon të jetë aty ku e pret më pak, edhe 20 vite pas vdekjes, po aq i përhershëm dhe i përkohshëm sa atë mëngjes, ndoshta në maj, kur më tha “Mirupafshim, amigo”, nga krahu tjetër i Boulevard St. Michel.

26 korik 1981

Përktheu David Hudhri



900 lekë

MIRA MEKSI



Hakmarria e Kazanovës

Onufri Novelë & Tregime